

ÇËSHËTJA E
FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE
INVALIDOR TË KOSOVËS NË KONTEKSTIN E
'FINALES SË MADHE' EVENTUALE
NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË





Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +381 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

ÇËSHTJEN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË KOSOVËS NË KONTEKSTIN E ‘FINALES SË MADHE’ EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Tetor 2019

STUDIM

MBI

ÇËSHTJEN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE
INVALIDOR TË KOSOVËS NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË
MADHE' EVENTUALE MIDIS KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje.....	1
Historia	2
Procesi i themelimit, transformimit dhe shuarjes së fondit për sigurimin pensional dhe invalidor të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.....	5
Reforma Pensionale me Rastin e Themelimit të UNMIK.....	15
Vlerësimi i dëmeve në para dhe jo-pasurore që rrjedhin nga suprimimi i BVISPI të ish KSAK dhe nga suspendimi i pagesës së pensioneve nga Serbia.....	25
Përfundimet	35
Rekomandimet	37
Anekset	41
Aneksi A Sigurimi Social në ish RSFJ para Kushtetutës së RSFJ të Vitit 1974	41
Aneksi B Intervistat me Pensionistët Kontribut Pagues	42

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
BKS	Banka Kombëtare e Serbisë
BVI	Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit
BVISPI	Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor
FPSP	Federata e Pavarur e Sindikatave të Pensionistëve
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
KEDNJ	Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut
KSAK	Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
LDB	Lufta e Dytë Botërore
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PKDNJ	Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
PNDESHK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RFPJ	Republika Federative Popullore e Jugosllavisë
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZSRS	Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë

Hyrje

1. Në këtë studim, qëllimi është që të vlerësohet borxhi potencial i Republikës së Serbisë ndaj pensionistëve kontributdhënës¹ si parakusht për të kërkuar kompenzim nga Republika e Serbisë, e cila në mënyrë të jashtëligjshme ka shuar dhe suspenduar pagesën e pensioneve për pensionistët kontributdhënës shqiptarë dhe jo-serbë² në Kosovë.

2. Objektivat e këtij studimi janë:
 - i) Rishikimi kritik i fakteve historike mbi situatën politike dhe sociale të shqiptarëve etnikë të Republikës së Kosovës dhe mbi konfliktin ndëretnik në mes të shumicës etnike shqiptare dhe serbëve në Republikën e Kosovës;
 - ii) Rishikimi kritik i aspekteve ligjore dhe ekonomike të procesit të themelimit, transformimit dhe shuarjes së jashtëligjshme të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të KSAK;
 - iii) Rishikimi kritik i aspekteve ligjore dhe ekonomike të reformës pensionale nën administrimin e UNMIK-ut;
 - iv) Rishikimi kritik i rolit të UNMIK, si i besuar politik i popullit të Republikës së Kosovës, në zgjidhjen e çështjes së Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSAK;
 - v) Rishikimi kritik i aktiviteteve të ndërmarra deri më tani nga ana e pensionistëve kontribut pagues me qëllim të ri-ushtimit të së drejtës mbi pension, të fituar përmes kontributeve të detyrueshme nga të ardhurat personale në Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSAK; dhe
 - vi) Vlerësimi i humbjeve monetare dhe jo-monetare që rrjedhin nga shuarja e jashtëligjshme e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSAK dhe suspendimi i jashtëligjshëm i pagesës së pensioneve për pensionistë kontributdhënës shqiptarë dhe jo-serbë.

¹Ata të cilët kanë fituar të drejtën themelore mbi sigurimin pensional dhe invalidor, sipas ligjit në fuqitë, ndër të tjera, në ish-Republikën Federative të Jugosllavisë.

²Në pensionistët kontribut pagues jo-serb nuk përfshihen pensionistët kontribut pagues malazesë, meqë për ta Republika e Serbisë nuk e ka suspenduar pagesën e pensioneve.

Historia

3. Të kesh informata për historinë e zhvillimeve politike dhe ekonomike të Republikës së Kosovës është parakusht për të kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të paanshme situatën aktuale, si dhe për të zhvilluar argumente reale rreth së drejtës për reparacionet (dëmshpërblimet) e luftës në Republikën e Kosovës, posaçërisht të drejtën për dëmshpërblime në lidhje me fondin pensional dhe invalidor të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (tani e tutje KSAK).
4. Në periudhën pas vdekjes së Titos, duke u përpjekur të përmbush ngritjen e tij politike, Slobodan Milosevic vendosi se strategjia më e mirë për arritjen e këtij qëllimi ishte të joshë (ngashënjejë) dhe mbështes minoritetin serb në Kosovë duke zvogëluar fuqinë e Qeverisë së Kosovës dhe duke shkaktuar krizë socio-ekonomike dhe politike në Kosovë. Revolucioni anti-burokratik shpërtheu dhe u karakterizua me shtypjen kulturore, politike dhe socio-ekonomike të popullatës etnike shqiptare. Në vitin 1989, Milosevici nëpërmjet autoritetit federal serb revokoi statusin ligjor të Kosovës të dhënë (garantuar) me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974. Në vitin 1990, Kuvendi Popullor i Serbisë kaloi (aprovoi) dy ligje speciale, Ligjin mbi Veprimin e Organeve Republikane në Kushte të Posaçme dhe Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës në Kushte të Posaçme. Ligji i parë është përdorur për t'i dhënë fund rendit kushtetues të ish Jugosllavisë dhe për heqjen e autonomisë së Kosovës, përderisa ligji i dytë, i cili ka qenë i aplikueshëm vetëm në Kosovë, shërbeu si bazë për futjen e masave të përkohshme të dhunshme. Nëpërmjet këtyre masave, punëtorëve shqiptarë në mbarë Kosovën iu është kërkuar të nënshkruajnë betimet e besnikërisë ndaj regjimit të sapoformuar serb. Sidoqoftë, duke u solidarizuar me kauzën kombëtare "të aspiratës për pavarësi", shumica e punëtorëve shqiptarë refuzuan ta nënshkruajnë atë. Në atë që pasoi, ndërmarrjet në pronësi të shtetit u vënë nën kontrollin direkt të qeverisë së Serbisë dhe punëtorët shqiptarë të këtyre ndërmarrjeve u larguan nga pozitat menaxhuese. Në Universitetin e Prishtinës, arsimiti në gjuhën Shqipe u ndalua dhe mësimdhënësit shqiptarë u pushuan nga puna

gjithashtu. Punëtorët shqiptarë u larguan nga pozitat në qeveri dhe media, spitale dhe industrinë e tjera të kontrolluara nga qeveria. Si rezultat, nga numri i gjithmbarshëm prej 164.000 punëtorëve shqiptarë të punësuar në vitin 1989, më shumë se 130.000 u përjashtuan nga puna deri në vitin 1992 dhe iu mohua e drejta për ndonjë kompensim material apo social.³ Në vitin 1991, duke kundërshtuar ndryshimet kushtetuese, të cilat kishin rezultuar me represionin Serb, përfaqësuesit politikë shqiptarë nga Kosova shpallën pavarësinë e Kosovës dhe adoptuan Kushtetutën e Kosovës në vitin 1992. Për më tepër, u organizua referendum i cili, ndonëse nuk u njoh ndërkombtarisht, por u vëzhgua, 98% e pjesëmarrësve të këtij referendumi përkrahën pavarësinë e Kosovës. Si rezultat, shqiptarët etnikë të Kosovës themeluan institucione paralele politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike.

5. Për shkak të represionit në rritje të ushtruar nga regjimi serb, shqiptarët etnikë të Kosovës formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në vitin 1995 dhe konflikti ndëretnik eskaloj në vitet 1989/1999. Me dështimin e serbëve për të nënshkruar marrëveshjen e paqes me UÇK gjatë konferencës së Paqes në Rambuje në vitin 1999, filloi fushata e bombardimeve të NATO-së. Pas disa muajve, bombardimet e NATO-s u pezulluan dhe Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara nxori Rezolutën 1244⁴ të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (tani e tutje Rezoluta 1244), e cila parashihte pavarësinë e Kosovës. Bazuar në Rezolutën 1244 dhe dokumentet plotësuese u themelua Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili e kishte rolin e kujdestarit politik me misionin e tij për të ushtruar sovranitetin në territorin e Kosovës në emër dhe në të mirë të popullatës së Kosovës duke synuar krijimin e parakushteve për pavarësimin e mundshëm të këtij territori, vetëqeverisje, si dhe mjaftueshmëri ekonomike.⁴

³Fetahu, A. (2015), 'Në mbrojtje të të drejtave të pensionistëve'. Në dispozicion në: <http://adilfetahu.com/wp-content/uploads/2016/01/ADIL-FETAHU-Ne-mbrojtje-te-te-drejtave-te-pensionisteve.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁴Perritt, H. (2004), 'Qëndrueshmëria Ekonomike dhe Statusi Final për Kosovën'. Në dispozicion në: <https://www.law.upenn.edu/journals/jil/articles/volume25/issue1/Perritt25U.Pa.I.Int%27Econ.L.259%282004%29.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

6. Ndonëse ende nën administrimin e UNMIK-ut, Kosova hyri në një fazë të re të qeverisjes duke krijuar Institucionet e saja të Përkohshme të Vetëqeverisjes përmes Rregullores 2001/9 të UNMIK-ut. Kjo Rregullore siguroi Kuadrin Kushtetues për formimin e institucioneve të tilla si Parlamentin, Presidentin, sistemin ekzekutiv dhe gjyqësor. Në vitin 2006, sikurse ishte paraparë me rezolutën 1244, Kosova filloi negociatat ndërkombëtare, të udhëhequra nga i Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara Martti Ahtisaari, për statusin e saj final politik. Pas një viti, draft projekt propozimi për zgjidhjen e statusit iu dorëzua të dyja palëve Prishtinës dhe Beogradit. Ky dokument shërbeu si bazë për draft Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe parashihte pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën. Si rezultat i kundërshtimit të Rusisë për këtë rezolutë nën arsyetimin se ndikon negativisht në parimin e sovranitetit të shtetit, ky dokument u rishkrua disa herë. Përkundër përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për të siguruar mbështetjen e Rusisë për rezolutën në fjalë, Rusia deklaroi se nuk do ta miratonte ndonjë rezolutë, për të cilën nuk pajtohen ose Prishtina ose Beogradi.

7. Në vitin 2008, Parlamenti i Kosovës shpalli pavarësinë, e cila aktualisht është njohur nga 116 shtete. Kuvendi i Serbisë i cili edhe më tutje e konsideron Kosovën si pjesë të territorit të saj sovran, shpreh se Deklarata e Pavarësisë e shpallur nga Kuvendi i Kosovës është jolegale nën arsyetimin se “nuk ishte në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, kushtetutën e Serbisë, Aktin Final të Helsinkit, Rezolutën 1244 (duke përfshirë edhe rezolutat e mëparshme) dhe Komisionin e Badinterit”. Duke kërkuar mbështetje për qëndrimin e saj, Serbia inicoi një kërkesë të drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi (GJND) për mendim këshillëdhënës mbi ligjshmërinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. GJND vendosi se *“miratimi i deklaratës së pavarësisë të datës 17 Shkurt 2008 nuk ka shkelur ligjin e përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit apo*

Kornizën Kushtetuese. Rrjedhimisht, miratimi i kësaj deklarate nuk përbën shkelje të asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare".⁵

8. Pas vendimit të GJND-së, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë të hartuar bashkërisht nga Bashkimi Evropian dhe Serbia, që përmban një kërkesë për një dialog të lehtësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë i cili do të " ishte një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, dhe se ai dialog do të promovonte bashkëpunimin, arritjen e përparimit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe do të përmirësonte jetët e njerëzve".⁶ Në përputhje me rrethanat, Kosova dhe Serbia ranë dakord për Marrëveshjen e Brukselit në vitin 2013. Negociatat momentalisht janë bllokuar, mirëpo deri tani nuk ka pasur ndonjë përparim serioz deri më tani.

Procesi i themelimit, transformimit dhe shuarjes së fondit për sigurimin pensional dhe invalidor të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

9. Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSAK është menaxhuar nga Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (BVISPI) si një sistem i pavarur i bazuar në parimin e solidaritetit mes gjeneratave. Fondi ka ofruar mjete për siguri materiale dhe shëndetësore (sociale), të cilat janë siguruar në bazë të punës dhe kontributit të detyrueshëm (përmes të cilave është fituar e drejta themelore mbi sigurimin pensional dhe invalidor). Fondi ka luajtur një rol të rëndësishëm socio-ekonomik në mirëqenien e përfituesve dhe ka shërbyer si një mjet i rëndësishëm financiar kundër skamjes (varfërisë së madhe) në pleqëri. Prandaj, shuarja dhe përvetësimi i jashtëligjshëm i BVISPI dhe suspendimi i

⁵ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (2010), 'Përputhja me Ligjin Ndërkombëtar e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në Lidhje me Kosovën'. Në dispozicion në: <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁶ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2010), 'Kërkesë për një mendim këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëse deklarata e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është në përputhje me ligjin ndërkombëtar'. Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/Documents/GA64298.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

jashtëligjshëm i pagesës së pensioneve nga ana e Serbisë i ka penguar pensionistët kontributdhënës në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tyre. Në vazhdim, fakte kyçe historike dhe ligjore janë diskutuar duke filluar nga viti 1946 kur është miratuar Kushtetuta e ish Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë mbi themelimin, transformimin dhe suprimimin e fondit, suspendimin e pagesës së pensioneve, dhe shkeljen e së drejtës mbi sigurimin pensional dhe invalidor, si një e drejtë themelore e njeriut, si dhe pasojat shkatërruese që këto kanë pasur mbi mirëqenien socio-ekonomike të pensionistëve kontributdhënës.

10. Sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, e drejta themelore mbi sigurimin social është rregulluar në bazë të Nenit 281 paragrafi 3:

“Federata përmes agjencive të saj do të:

(3) ... rregullojë ato të drejta themelore të punëtorëve në punën e bashkuar përmes të cilave ata sigurojnë statusin e tyre, siç parashihet me këtë Kushtetutë, në marrëdhëniet vetëqeverisëse dhe socio-ekonomike dhe të drejtat dhe obligimet themelore të organizatave të punës së bashkuar, bashkësive vetëqeverisëse të interesit, organizatave dhe komuniteteve tjera vetëqeverisëse, si dhe komuniteteve socio-politike mbi burimet shoqërore; rregullojë të drejtat themelore të njerëzve që punojnë lidhur me sigurimin dhe solidaritetin social; të përcaktojë parimet lidhur me statusin, të drejtat dhe detyrimet e Prokurorit Shoqëror të Vetëqeverisjes;”⁷

11. Po ashtu, pas decentralizimit dhe bartjes së pushtetit tek qeveritë e njësive federale nga pushteti federal, të akorduar përmes Kushtetutës së 1974 të RSFJ-së, zhvillimi dhe menaxhimi i sistemeve të sigurimit social i është bartur si përgjegjësi njësive konstituive të RSFJ-së.⁸ Sipas kësaj, republikave dhe krahinave i është bartur përgjegjësia ligjore për zhvillimin dhe menaxhimin, ndër organizatave tjera politike,

⁷ Kuvendi i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1974), ‘Kushtetuta e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë 1974’ fq.225. Në dispozicion në: <http://www.worldstatesmen.org/Yugoslavia-Constitution1974.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁸ Lukovic, S. (1998), ‘Sigurimi Social në Republikën Federative të Jugosllavisë’ fq. 81-92.

shoqërore dhe ekonomike, dhe të sistemeve të sigurimit pensional dhe invalidor përmes bashkësive vetëqeverisëse të interesit, në bazë të parimit të solidaritetit, reciprocitetit dhe punës së kaluar. Baza ligjore për këtë ishte përcaktuar përmes Nenit 53 sipas të cilit *“për të realizuar sigurinë e tyre sociale njerëzit punonjës themelojnë bashkësinë vetëqeverisëse të interesit në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor dhe formave tjera të sigurimit social në të cilat ata bashkojnë mjetet për këtë qëllim dhe i rregullojnë, në bazë të parimit të solidaritetit dhe reciprocitetit dhe punës së kaluar, obligimet e veta të përbashkëta dhe individuale ndaj Bashkësisë dhe të drejtat e përbashkëta dhe individuale që i realizojnë në të.”*⁹

12. Sipas Nenit 163, bashkësive të pavarura vetëqeverisëse të interesit për sigurim pensional dhe invalidor të republikave dhe krahinave përkatëse të RSFJ-së iu bartet përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme për sigurimin social, si dhe për pagesën e pensioneve dhe përfitimeve tjera, siç ishte sigurimi shëndetësor, për pensionistët ekzistues kontributdhënës në bazë të kontributeve të tyre. Përgjegjësitë tjera përfshinin rregullimin e sigurimit social të ngjashëm për pensionistë jo-kontributdhënës, në bazë të parimit të solidaritetit dhe reciprocitetit: *“E drejta e punëtorëve mbi sigurimin social fitohet përmes sigurimit të detyrueshëm në bazë të parimit të solidaritetit dhe reciprocitetit dhe punës së kaluar, në bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, në bazë të kontributeve të mbledhura nga të ardhurat personale të punëtorëve dhe kontributeve të mbledhura nga të ardhurat e organizatave të punës së bashkuar, ose të kontributeve të mbledhura nga të ardhurat e organizatave ose bashkësive tjera në të cilat ata punojnë. Në bazë të këtij sigurimi, punëtorët, në përputhje me statutin, fitojnë të drejtën mbi sigurimin shëndetësor dhe përfitimet tjera në rast të sëmundjes, të drejtën për shtesat për fëmijët, të drejtën për përfitimet në rast të pakësimit ose humbjes së aftësisë për të punuar, papunësisë ose pleqërisë dhe forma tjera të sigurimit social, si dhe për familjarët – të drejtën për sigurim shëndetësor, për pension për të mbijetuarit, dhe forma tjera të përfitimeve nga*

⁹ Kuvendi i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1974), ‘Kushtetuta e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë 1974’ fq.111. Në dispozicion në: <http://www.worldstatesmen.org/Yugoslavia-Constitution1974.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

sigurimi social. Sigurimi social për njerëzit që punojnë dhe njerëzit tjerë që nuk janë të mbuluar nga skema e sigurimit social të detyrueshëm rregullohet me statut në bazë të parimit të solidaritetit dhe reciprocitetit.”¹⁰

13. Në bazë të dispozitave të Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, për të komplementuar kornizën ligjore mbi rregullimin e të drejtës themelore mbi sigurimin social, në vitin 1982 RSFJ miratoi Ligjin mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor, në të cilin u rregulluan vetëm çështjet themelore të sigurimit pensional, derisa çështjet tjera iu bartën si përgjegjësi njësive federale.¹¹ Sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, secila republikë dhe krahinë ka pasur përgjegjësinë për të hartuar ligjin në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor dhe për të themeluar fondin e pavarur të sigurimit pensional dhe invalidor. Në bazë të këtyre ligjeve individuale, fondet, si entitete juridike, janë themeluar si Bashkësi të pavarura Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) për territorin e njësisë federale përkatëse, në bazë të parimit të solidaritetit, reciprocitetit dhe punës së kaluar. Fondet janë menaxhuar dhe administruar përmes statuteve të tyre si BVI.¹²

14. Sipas Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, Ligjit të vitit 1982 të RSFJ-së mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor, dhe Ligjit të vitit 1983 të KSAK mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor, e drejta për sigurime sociale, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për sigurim pensional dhe invalidor, është e drejtë njerëzore themelore, e cila fitohet në bazë të punës dhe kontributeve të detyrueshme nga të ardhurat personale (Neni 281 Paragrafi 3, Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974; Neni 3, Paragrafi 8, Neni 108 i Ligjit të KSAK të

¹⁰ Kuvendi i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1974), ‘Kushtetuta e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë 1974’ fq.174. Në dispozicion në: <http://www.worldstatesmen.org/Yugoslavia-Constitution1974.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹¹ Kälın, W., Koser, K., Solomon, A., dhe Williams, R. C. (2010), ‘Përfshirja e Parimeve Udhëzuese mbi Zhvendosjen e Brendshme në Ligjin Vendor: Çështjet dhe Sfidat Nr. 41. Në dispozicion në: https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/0119_internal_displacement_complete.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹² Në Kushtetutat e mëvonshme, Jugosllavia ka pasuruar sistemin e sigurimit social dhe të sigurisë duke i mbuluar me të drejtat mbi sigurimin edhe kategoritë tjera, siç ishin familjet e punëtorëve, zejtarët e pavarur dhe të tjerë.

vitit 1983).¹³ Prandaj, e drejta për sigurim pensional dhe invalidor është rregulluar si e drejtë njerëzore themelore dhe si e tillë kjo e drejtë (i) nuk mund të transferohet tek një person tjetër (Neni 5, Ligji mbi të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor RSFJ i vitit 1982) dhe (ii) nuk mund të shfuqizohet, përveç kërkesave në shumta të papaguara dhe pretendimeve të papaguara (Neni 5, Ligji mbi të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor i RSFJ i vitit 1982; Neni 9 i Ligjit të KSAK të vitit 1983). Sipas ligjit në fuqi të Republikës së Serbisë, e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor është e definuar dhe e rregulluar si e drejtë personale, e cila është e patjetërsueshme dhe nuk mund të vjetërsohet (tjetërsohet).¹⁴ Ligji serb parasheh që e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor është e drejtë personale, e cila nuk mund të transferohet në persona tjerë dhe se nuk mund të kufizohet, “përveç të drejtës për të kërkuar pensionin e përlogaritur”.¹⁵ Interpretimi ligjor i ofruar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë¹⁶ shërben si një provë e mirëfilltë shtesë në përkrahje të asaj se e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor është një e drejtë personale. Në vlerësimin ligjor, GJEDNJ konsideron se *“të drejtat ekzistuese pensionale të aplikantëve kanë konstituar (d) një posedim (pasuri) brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.”* Prova tjera shtesë në formën e interpretimit ligjor se e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor është e drejtë pronësore ofrohen edhe nga Paneli Këshillëdhënës mbi të Drejtat e Njeriut në lëndën gjyqësore Krasniqi ndaj UNMIK-ut¹⁷, ku Paneli shpjegon se *“është konstatuar se të drejtat e fituara nga pensioni konsiderohen të drejta pronësore dhe se zvogëlimi apo ndalja e pensionit*

¹³Kriteret përfshijnë moshën e pensionimit dhe stazhin, ose të dyja. Punëtorët, në kushte të caktuara, kanë pas mundësi të pensionohen para moshës së pensionimit. Përfitimet e pensionit janë llogaritur në bazë të të ardhurave personale mesatare për 10 vitet me të ardhurat më të larta.

¹⁴ Kuvendi i Serbisë (2018), ‘Ligji nr. 73/2018 mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor’. Në dispozicion në: <http://pio.rs/images/dokumenta/Zakoni/2018/Zakon%20o%20PIO%20-2018.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹⁵ Kuvendi i Serbisë (2018), ‘Ligji nr. 73/2018 mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor - Neni 6’. Në dispozicion në: <http://pio.rs/images/dokumenta/Zakoni/2018/Zakon%20o%20PIO%20-2018.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2012), ‘Grudic v. Serbia, Aktgjykimi i Strasbourgut’. Në dispozicion në: http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p-br-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹⁷ Paneli Këshillëdhënës mbi të Drejtat e Njeriut (2016), ‘Krasniqi v. UNMIK’. Në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/08_10%20Krasniqi%20FINAL%2017may16.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

rrjedhimisht mund të përbëjnë një interferencë në shfrytëzimin e qetë të pronave që mbrohet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të GJEDNJ’.

15. Sipas Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, Ligjit të vitit 1982 të RSFJ-së mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor, KSAK kishte të drejtë të merrte përsipër të gjitha përgjegjësitë ligjore në fushën e sigurimit social brenda territorit të krahinës (KSAK). Ish-KSAK ka ushtruar të drejtën e saj mbi themelimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemit të sigurimit social të pavarur të garantuar me Kushtetutën e vitit 1974 të RSFJ-së.¹⁸ Në Kushtetutën e vitit 1974 të KSAK është ofruar baza ligjore për themelimin e Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit, ndër të tjera, edhe në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor.¹⁹ Rrjedhimisht, në vitin 1976 Kuvendi i KSAK ka miratuar Ligjin mbi Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor (më tutje Ligji mbi BVISPI). Sipas këtij ligji, punonjësit themeluan Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit (më tutje BVI) si person juridik *“me qëllim të sigurimit të sigurisë së vet sociale, punëtorët themelojnë, Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Sigurim Pensional dhe Invalidor ...”* (Neni 1 Ligji mbi BVISPI i KSAK i vitit 1976). Për më shumë, ligji parashihte që BVI për Sigurim Pensional dhe Invalidor të themelohet nga punonjësit dhe për punonjësit në territorin e ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Neni 5 Ligji mbi BVISPI i vitit 1976 i KSAK, f. 444). Në bazë të Nenit 8, BVISPI, ndër të tjera, *“implementon dhe zbaton planin e zhvillimit, rregullon mënyrën dhe procedurën e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, siguron kushtet për shfrytëzimin dhe zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor, merr masat për pengimin e shfaqjes së invaliditetit në pajtim me të arriturat e shkencës bashkëkohore, punon për përparimin e mbrojtjes ndaj invaliditetit, siguron mjetet për sigurimin pensional dhe invalidor, kryen edhe punët tjera me interes të përbashkët në lëminë e sigurimit pensional dhe invalidor të caktuar me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e saj dhe me*

¹⁸ Kuvendi i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1974), ‘Kushtetuta e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë 1974 – Nenet 53, 163, 281’. Në dispozicion në: <http://www.worldstatesmen.org/Yugoslavia-Constitution1974.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

¹⁹ Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1974), ‘Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës – Nenet 50, 51, 52’

statut.” Po ashtu, BVISPI qeverisej nga Kuvendi i saj, të cilin “*e përbëjnë delegatët e punonjësve në organizatat themelore të punës së bashkuar, ...*” (Neni 10 Ligji mbi BVISPI i KSAK i vitit 1976) dhe Kuvendi i saj miraton statutin e BVISPI (Neni 180, Ligji mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor i KSAK i vitit 1983). Prandaj, BVISPI e ish KSAK, sipas ligjeve, u themelua si një subjekt juridik i pavarur për të menaxhuar dhe qeverisur sistemin e sigurimit pensional dhe invalidor në territorin e ish KSAK (Neni 3 dhe Neni 5, Ligji mbi BVISPI i KSAK). Me fjalë tjera, BVISPI u themelua nga punëtorët dhe punonjësit e tjerë si një Fond mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor për të siguruar sigurimin social dhe material në territorin e ish KSAK. Si i tillë, Fondi nuk ka pasur asnjë obligim ligjor ndaj BVISPI të Republikës së Serbisë, që gjithashtu ishte subjekt juridik i pavarur.²⁰

16. Në vitin 1983, Kuvendi i ish KSAK miratoi Ligjin mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (Ligji mbi SPI i KSAK i vitit 1983) përmes të cilit “*rregulloi në detaje të drejtën themelore për sigurimin pensional dhe invalidor në përputhje me Ligjin e RSFJ-së mbi të drejtat themelore nga sigurimi pensional dhe invalidor (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, Ligji Nr. 23/82 dhe 77/82) dhe rregulloi të drejtat tjera themelore nga sigurimi pensional dhe invalidor.*” (Neni 1, Ligji mbi SPI i KSAK i vitit 1983). Sipas këtij ligji, punëtorët dhe njerëzit tjerë punonjës i kanë krijuar vetes siguri sociale dhe materiale përmes punës dhe kontributeve të detyrueshme në Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të themeluar për territorin e ish KSAK (Neni 3, Neni 5, Neni 8, Neni 108, Ligji mbi SPI i KSAK i vitit 1983). Kështu, në ish KSAK punëtorët dhe njerëzit tjerë punonjës përmes BVISPI i kanë rregulluar “*obligimet e përbashkëta dhe individuale*” dhe i kanë realizuar “*të drejtat e tyre të përbashkëta dhe individuale nga sigurimi pensional dhe invalidor, në përputhje me marrëveshjen vetëqeverisëse, me marrëveshjen shoqërore dhe me ligjin*” (Neni 5, Ligji mbi SPI i KSAK i vitit 1983). Rrjedhimisht, në ish KSAK e drejta nga

²⁰Në vitin 1977, Kuvendi i ish KSAK miratoi Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor. Ndër të tjera, Ligji parashihte që termi “komuniteti krahinor për sigurimi pensional dhe invalidor” të zëvendësohet me termin “bashkësia vetëqeverisëse e interesit sigurim pensional dhe invalidor”. Ligje shtesë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor u miratuan nga Kuvendi i ish KSAK në vitet 1979 dhe 1980.

sigurimi pensional dhe invalidor ka qenë një e drejtë themelore e fituar në bazë të punës dhe kontributeve të detyrueshme nga të ardhurat personale të punëtorëve. Siç përshkruhet në Nenin 11 të këtij ligji, këto të drejta themelore nga sigurimin pensional dhe invalidor të të siguarëve përbëheshin nga: (i) e drejta në pension pleqërie, (ii) e drejta në pension invalidor, dhe (iii) e drejta në pension familjar. Në po këtë nen, parashihej që BVISPI mund të aplikonte edhe të drejta tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor. Të drejtat tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor të parapara me këtë ligj (përveç të drejtave themelore të rregulluara me Ligjin mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor i RSFJ), përfshinin: (i) të drejtën për pensionim të parakohshëm pleqërie, (ii) të drejtën për pension të pjesshëm, (iii) të drejtën për ndihmë dhe kurim mjekësor, dhe (iv) të drejtën për rehabilitim profesional të fëmijëve me të meta zhvillimi. Detyrimet, kriteret dhe masat e caktimit të vlerës së mjeteve financiare, si dhe mënyra dhe afatet e mbledhjes së kontributeve të detyrueshme për sigurimin pensional dhe invalidor rregulloheshin përmes marrëveshjes së vetëqeverisjes (Neni 186, Ligji mbi SPI i KSAK i vitit 1983). Në Nenin 190, ligji gjithashtu parashihte që shkalla e kontributit të detyrueshëm për sigurim pensional dhe invalidor duhej të përcaktohej asisoj që mjetet e arkëtuara të mjaftonin për të mbuluar detyrimet e BVISPI, për të krijuar një rezervë dhe një nivel të duhur të aseteve qarkulluese (paratë dhe ekuivalentët e saj). Duhet të theksohet se definimi i të drejtave themelore dhe kriterëve, siç ishin mosha e pensionimit, mosha e pensionimit të parakohshëm, si dhe stazhi ishin përgjegjësi ligjore e qeverisë federale.

17. Pas përmbysjes së rendit kushtetues të ish RSFJ-së nga ana e Republikës së Serbisë, përmes Ligjit mbi Veprimin e Organeve Republikane në Kushte të Posaçme (dhe përmes Kushtetutës së re të Republikës së Serbisë), Serbia dhunshëm rrënoi statusin e Kosovës si Krahinë Socialiste Autonome përmes Ligjit mbi Pushimin e Punës së Kuvendit të KSA të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës të vitit 1990. Kështu, regjimi i Milosevic imponoi qeverisje direkte në

Kosovë përmes Serbisë.²¹ Përmes këtij ligji, Serbia revokoi kompetencat dhe pushtetin ligjor dhe legjitim të institucioneve të ish KSAK. Kuvendi i Republikës së Serbisë mori të drejtat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të ish KSAK, ndërsa Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Serbisë mori të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të ish KSAK. Sipas ligjit, u shkarkuan funksionarët e Kuvendit të ish KSAK, anëtarët e Këshillit Ekzekutiv dhe funksionarët që udhëhiqnin institucionet administrative të ish KSAK, organizatat administrative dhe shërbimet profesionale, sekretari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit, si dhe zëvendësi i tij.²² Po ashtu, Kuvendi i Serbisë miratoi Ligjin nr. 30/90 mbi Marrëdhëniet e Punës nën Masa të Dhunshme, i cili zbatohet vetëm në ish KSAK. Në bazë të këtij ligji, regjimi serb filloi zbatimin e masave të dhunshme të përkohshme në Kosovë dhe miratoi 367 urdhra administrativë mbi zbatimin e masave të përkohshme, nga të cilët 237 ndërlidheshin me ndërmarrjet ekonomike, 101 me institucionet arsimore, kulturore dhe shëndetësore, 20 me kooperativat bujqësore dhe 9 me media.²³ Rrjedhimisht, të gjithë shqiptarët etnikë që mbanin pozita menaxheriale u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me punëtorë serbë ose malazezë, duke ndryshuar kështu strukturën etnike të menaxhmentit në organizatat ekonomike. Në Universitetin e Prishtinës mësimdhënia në gjuhën shqipe u shpall si jologjore, mësimdhënësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe filloi zbatimi i planprogrameve serbe. Përveç kësaj, me masat e përkohshme parashihej që punëtorët shqiptarë të nënshkruanin betimin e besnikërisë ndaj regjimit të posaformuar të drejtpërdrejt nga Serbia. Kjo gjë u refuzua nga shumica e punëtorëve shqiptarë që punonin në institucionet qeveritare, institucionet shoqërore dhe ndërmarrjet ekonomike. Për shkak të zbatimit të masave të përkohshme dhe refuzimit të nënshkrimit të betimit të besnikërisë, përafërsisht 130.000 punëtorë shqiptarë u pushuan nga puna jashtëligjshëm. Si

²¹ Fetahu, A. (2015), 'Në mbrojtje të të drejtave të pensionistëve'. Në dispozicion në: <http://adilfetahu.com/wp-content/uploads/2016/01/ADIL-FETAHU-Ne-mbrojtje-te-te-drejtave-te-pensionisteve.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

²² Gazeta Zyrtare e KSAK (1990), 'Ligji mbi Pushimin e Punës të Kuvendit të KSAK dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK' nr. 27, f. 988.

²³ Fetahu, A. (2015), 'Në mbrojtje të të drejtave të pensionistëve'. Në dispozicion në: <http://adilfetahu.com/wp-content/uploads/2016/01/ADIL-FETAHU-Ne-mbrojtje-te-te-drejtave-te-pensionisteve.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

rezultat i kësaj, atyre jashtëligjshëm iu mohua e drejta themelore nga kompenzimi social dhe material, duke përfshirë këtu edhe të drejtën nga sigurimi social në formë të asistencës në rast të papunësisë, si dhe e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor, e drejtë të cilin ata e kishin fituar përmes punës dhe kontributeve të detyrueshme në bazë të ligjeve në fuqi.²⁴

18. Me zbatimin e masave të dhunshme të përkohshme në ish KSAK, Bashkësitë Vetëqeverisëse të Interesit u suprimuan. Po ashtu, në vitin 1992, Kuvendi i Serbisë miratoi Ligjin e ri mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor përmes të cilit u suprimua tërësisht BVISPI dhe kështu Ligji i KSAK i vitit 1983 mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor u shfuqizua (Neni 248). Në bazë të këtij Ligji të Serbisë të viti 1992, Serbia suprimoi BVISPI të ish KSAK (Neni 242 Paragrafi 6) dhe e integroi të njëjtën në BVISPI të Republikës së Serbisë. Rrjedhimisht, të gjitha pasuritë, mjetet, inventari, të drejtat, por edhe obligimet e BVISPI të ish KSAK i mori (përvetësoi) BVISPI e Serbisë (Neni 243). Përmes këtij veprimi të jashtëligjshëm, arbitrar dhe të padrejtë, Serbia përvetësoi Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të qytetarëve të ish KSAK. Mirëpo, duhet të ritheksohet se Serbia në bazë të këtij ligji mori edhe të gjitha OBLIGIMET (DETYRIMET) LIGJORE të BVISPI të ish KSAK, duke përfshirë këtu, por jo duke u kufizuar vetëm në pagesën e sigurimit pensional dhe invalidor.

19. Gjatë periudhës 1992-1998, Serbia i respektoi, por ka dilemë dhe mosmarrëveshje rreth asaj nëse i respektoi në plotëni, detyrimet e saj ligjore lidhur me Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor. Me eskalimin e situatës dhe fillimin e luftës në vitin 1998, Serbia jashtëligjshëm dhe në mënyrë arbitrare ndërpreu pagesën e sigurimit pensional dhe invalidor për pensionistët kontributdhënës shqiptarë dhe jo-serbë që jetonin në Drenicë, Malishevë, Drenas dhe disa zona tjera. Po ashtu, me fillimin e kampanjës së bombardimeve nga NATO në vitin 1999 dhe me themelimin e misionit të UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244, Serbia ua mohoi të drejtën e fituar nga sigurimi pensional dhe invalidor pensionistëve kontributdhënës shqiptarë dhe jo-

²⁴ Po aty.

serbë të Kosovës duke i ndërprerë pagesat e sigurimit pensional dhe invalidor për ta.

Reforma Pensionale me Rastin e Themelimit të UNMIK

20.Gjatë administrimit të UNMIK, një sistem i ri pensional u themelua në bazë të Rregullores Nr. 2001/35 të UNMIK dhe i njëjti u operacionalizua në vitin 2002.²⁵ Sipas Rregullores së UNMIK nr. 2001/35, Rregullores së UNMIK nr. 2005/20, Ligjit nr. 03/L-084 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së UNMIK nr. 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK nr. 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, Ligjit nr. 04/L-101 mbi Fondin Pensional të Kosovës, Ligjit nr. 04/L-168 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101, Ligjit nr. 05/L-116 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101, dhe Ligjit nr. 04/L-131 mbi Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, pensionet e detyrueshme përbëhen nga dy lloje: pensionet bazë dhe pensionet individuale të kursimeve. Ligji parasheh edhe dy lloje të pensioneve jo të detyrueshme: pensionet plotësuese të punëdhënësit dhe pensionet plotësuese individuale.

21.Pensionet bazë të detyrueshme, ndryshe të quajtura edhe Shtylla I, përbëhen nga pensioni bazë i moshës dhe pensioni invalidor i punës që financohen nga buxheti i Kosovës dhe jo përmes ndonjë tatimi në pagë të përcaktuar për këtë qëllim.²⁶ Lloji i parë i paguhet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën e pensionimit (gjegjësisht moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe më të vjetër) pavarësisht a kanë qenë të punësuar apo jo. Pensioni invalidor i punës është i definuar më ngushtë dhe merr për bazë vetëm invaliditetin e plotë dhe të përhershëm si kriter. Skema pensionale bazohet në parimin e mbulimit universal dhe shkalla e njëjtë e përfitimit i paguhet secilit përfitues, pa marrë parasysh ndonjë

²⁵ Gubbels et al. (2007), 'Reforma e pensioneve në Kosovë: Arritjet dhe Mësimet'. Në dispozicion në: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.504.7425&rep=rep1&type=pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

²⁶ Po aty.

lloj kategorizimi. Si rezultat, kjo skemë nuk përfillë as kontributet e detyrueshme në fondin e kaluar (BVISPI të ish KSAK) që janë paguar nga disa pensionistë as stazhin e punës. Kjo nënkupton që kjo skemë trajton në mënyrë diskriminuese “pensionistët kontributdhënës” dhe ata me përvojë pune.

22. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 11/2007 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ekzekutimin e Vendimit të Qeverisë nr. 13/277, vetëm në vitin 2007 Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi në favor të kategorizimit të përfituesve të pensioneve duke respektuar të drejtën mbi pension të pensionistëve kontributdhënës të sistemit të kaluar. Kështu, qeveria vendosi që pensioni bazik të rritet për 35 Euro në muaj për të gjithë pensionistët, “të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional brenda sistemit të ish-Jugosllavisë”. (Ligji nr. 04/L-131, Neni 12). Ngjashëm me rregulloret e kaluara dhe ligjet mbi sistemin pensional, ky vendim qeveritar sërish karakterizohet me trajtim diskriminues. Vendimi i ri diskriminon ata të cilët kanë paguar për më pak se pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional,²⁷ sepse i trajton njëjtë me të gjithë ata që nuk kanë bërë asnjë pagesë të kontributeve të detyrueshme për stazhin pensional para vitit 1999. Pra, kontributet e tyre që i kanë paguara për më pak se 15 vite nuk përfillen fare sipas skemës së re.

23. Shtylla I e pensioneve është administruar dhe menaxhuar nga Administrata e Pensionale e Kosovës, si njësi administrative, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ministria e Financave ishte përgjegjëse për përcaktimin e shumës mujore të përfitimeve në bazë të kostos së shportës së konsumit në Kosovës. Kjo shumë më pas u aprovua nga Qeveria e Republikës së Kosovës, varësisht nga kufizimet fiskale dhe nga parimi i qëndrueshmërisë fiskale. Shuma e pensionit bazik është e njëjtë me shumën e pensionit invalidor të punës. Pensioni bazik dhe ai invalidor i punës ndërlidhen me koston e shportës së konsumit me qëllimin që të reflektohet standardi për nevojat e ushqimit bazë, d.m.th. situata

²⁷Një pjesë e madhe e pensionistëve kontribut pagues janë shkarkuar nga puna me dhunë dhe jashtëligjshëm gjatë zbatimit të masave të dhunshme nga ana e regjimit të drejtëpërdrejtë të Serbisë.

ekonomike, dhe jo vendimet politike.²⁸ Sipas Grupit për Studime Juridike dhe Politike, të cilët bazohen në një artikull të publikuar në gazetën ditore Koha Ditore mbi pamjaftueshmërinë e pensionit, tregojnë se shuma e pensionit nuk është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike për ushqim, edhe sikur shpenzimet për nevoja shëndetësore dhe të banimit të ishin të mbuluara me ndonjë skemë tjetër, gjë që i lë “pensionistët në një gjendje të mjerueshme varfërie”.²⁹ Rrjedhimisht, një program i tillë konsiderohet më shumë si asistencë sociale sesa si skemë pensionale. Përkundër vendimit të vitit 2007 që jep të drejtën në një shtesë prej 35 Euro në muaj për pensionistët kontributdhënës, të cilët kanë dëshmuar që kanë kryer pagesën e kontributeve të detyrueshme për së paku 15 vite në sistemin e kaluar, shuma e pensioneve është e pamjaftueshme për të mirëmbajtur një standard adekuat të jetesës.

24. Sipas Gubbels et al.³⁰, masa deri në të cilën merren parasysh obligimet pensionale të sistemit të vjetër gjatë themelimit të sistemit të ri pensional paraqet një çështje të rëndësishme dhe të ndjeshme gjatë reformave pensionale në tërë botën. Në rastin e Kosovës, Shtylla I e sistemit të ri ofron mbulim univerzal në kuptimin që skema i mbulon të gjithë pensionistët kontributdhënës dhe qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë mbushur moshën e pensionimit (gjegjësisht moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe më të vjetër). Edhe pse i ofron pensione pensionistëve kontributdhënës, të cilët e kanë fituar të drejtën në pension përmes kontributeve të paguara në fondin e kaluar sipas kornizës ligjore të ish Jugosllavisë, sistemi i ri, përmes Shtyllës I, nuk i pranon/njeh ligjërisht detyrimet e sistemit të vjetër pensional. Prandaj, reforma pensionale është realizuar mbi bazën e parimit se

²⁸ Gubbels et al. (2007), ‘Reforma e pensioneve në Kosovë: Arritjet dhe Mësimet’. Në dispozicion në: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.504.7425&rep=rep1&type=pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

²⁹ GLPS (2012), ‘Sistemi i pensioneve në Kosovë: Një raport politikash nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike - Shqyrtimi i gjendjes aktuale, sfidat kryesore dhe boshllëqet’. Në dispozicion në: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2012/12/Pension-System-in-Kosovo.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

³⁰ Gubbels et al. (2007), ‘Reforma e pensioneve në Kosovë: Arritjet dhe Mësimet’. Në dispozicion në: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.504.7425&rep=rep1&type=pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

themelimi i një sistemi të ri pensional paraqet një çështje politike tjetër nga çështja e suspendimit të pagesave dhe detyrimeve të sistemit të vjetër. Në këtë drejtim, është vlerësuar se detyrimet, të cilat rrjedhin nga sistemi i vjetër, dhe respektimi i të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, të cilin e kanë fituar pensionistët kontributdhënës kosovarë, janë përgjegjësi e fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Serbisë. Gjithashtu, është vlerësuar se kjo çështje politike duhet të trajtohet ndaras nga procesi i reformës pensionale. UNMIK-u nuk i kishte pranuar detyrimet e sistemit të vjetër pensional i cili ishte integruar në atë të Beogradit dhe zgjidhja e këtij problemi ishte shtyrë për t'ju nënshtruar një dialogu potencial në të ardhmen në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mirëpo, reforma pensionale nuk kishte paraparë implikimet ligjore lidhur me pakësimin apo ndryshimin e detyrimeve të sistemit të vjetër pensional që konsiderohen se janë përgjegjësi e fondit pensional me bazë në Beograd.

UNMIK si Administrues i Besuar Politik (Political Trustee) dhe Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i ish KSAK

25. Pas intervenimit të NATO-s në Kosovë në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244 dhe dokumentet rrjedhëse zbatuese, në bazë të të cilave u themelua Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më tutje UNMIK) si një administrim i besuar politik, përderisa pavarësia e Republikës së Kosovës ishte paraparë si një mundësi.³¹ Sipas definicionit të ofruar nga Perritt, një administrim i besuar politik paraqet një shtet apo grup shtetesh, të cilat administrojnë një territor në emër të dhe për përfitime të popullit të atij territori, duke u fokusuar në pavarësimin eventual të territorit, vetëqeverisjen dhe

³¹ Perritt, H. (2004), 'Qëndrueshmëria Ekonomike dhe Statusi Final për Kosovën'. Në dispozicion në: <https://www.law.upenn.edu/journals/jil/articles/volume25/issue1/Perritt25U.Pa.I.Int%27Econ.L.259%282004%29.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

mjaftueshmërinë ekonomike të tij.³² Autori ka për qëllim të shpjegojë se Kosova ishte “shembulli më i mirë i administrimit të besuar politik”. UNMIK ishte administrues i besuar politik që ushtroi sovranitetin dhe udhëhoqi me Kosovën (duke njohur sovranitetin jugosllav) në emër të popullit të Kosovës, si përfituesi i këtij administrimi të besuar politik, deri në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

26. Sipas autorit, parakusht për shtet-ndërtim është që administrimi i besuar politik ta vlerësojë zhvillimin ekonomik si një nga prioritetet kyçe. Perritt³³ argumenton se në shumicën e administimeve të besuara politike zhvillimi ekonomik i sektorit privat nuk ishte përfillur nga ana e administruesit të besuar dhe se fokusi ishte vënë në radhë të parë në ndihma humanitare, të drejtat e njeriut dhe në themelimin e institucioneve politike vendore. Sipas tij, rasti i administrimit të besuar politik të UNMIK-ut në Kosovë nuk përbën një përjashtim. UNMIK nuk ka bërë dallim në mënyrë të mirëfilltë në mes të funksioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore që i kishte ushtruar si një administrues i besuar politik në Kosovë. UNMIK u fokusua thujse ekskluzivisht në rindërtimin e infrastrukturës fizike dhe në stabilitetin makroekonomik, duke dështuar kështu që të vlerësojë zhvillimin ekonomik si prioritet. Po ashtu, UNMIK pengoi punën e përfaqësuesve të qeverisë së Kosovës në përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë për zhvillimin e sektorit privat. Si rezultat, norma e varfërisë dhe papunësisë mbetën të larta, përderisa një strategji për vetëmjaftueshmëri thujse nuk ekzistoi. Kjo çoi në pakënaqësi dhe kritikë ndaj UNMIK –ut nga populli i Kosovës, si përfitues i administrimit të besuar politik.

27. Mungesa e përparimit dhe zhvillimit ekonomik gjatë administrimit të besuar politik nga UNMIK u vlerësua të jetë kryesisht rezultat i paqartësive apo kuptimit jo të qartë nga ana e UNMIK-ut të misionit të vet, i cili ishte garantuar përmes Rezolutës 1244, dhe rezultat i paqartësive apo kuptimit jo të qartë nga ana e Bankës Botërore të mandatit të vet, i cili ishte garantuar nga Akti Themelues i Bankës Botërore, mbi

³² Perritt, H. (2003), ‘Strukturat dhe Standardet për Administrimin e Besuar Politik’. Në dispozicion në: <http://www.kentlaw.edu/perritt/courses/seminar/ucla-jilfa-published-wl.htm> [Qasur më: 10 shtator 2019].

³³ Po aty.

përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre (UNMIK dhe Bankës Botërore) për të promovuar zhvillimin ekonomik në Kosovë.³⁴ Megjithatë, autori shpjegon se sipas Rezolutës 1244, UNMIK-u ka pasur pushtetin mbi pasuritë e Kosovës si një administrues i besuar, dhe kështu me konceptin e administruesit të besuar politik ka pasur mandatin për të stimuluar zhvillimin ekonomik lokal në Kosovë. Po ashtu, Banka Botërore kishte identifikuar një strategji mbi përkrahjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë përmes UNMIK-ut.

28. Në bazë të konceptit të administrimit të besuar politik, e drejta e UNMIK-ut (administruesi i besuar politik) për të ushtruar sovranitetin në Kosovë ishte e kufizuar “vetëm në bazë të asaj se çka shërbente interesat e popullit të Kosovës dhe asaj se çka do të ishte në përputhje me mandatin e UNMIK-ut për të çuar Kosovën drejt statusit final”.³⁵ Sipas kësaj, UNMIK-ut i është dashur të veprojë si një administrues i besuar politik i popullit të Kosovës dhe në përputhje me interesat e popullit të Kosovës të iniciojë një dialog në mes të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës dhe atyre të Qeverisë së Serbisë, në mënyrë që të arrihej një marrëveshje për kthimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK që e kishte përvetësuar Serbia jashtëligjshëm.

29. Në vitin 2005, ministri Ibrahim Selmanaj³⁶ theksoi se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës ka kërkuar nga administrata e UNMIK-ut të iniciojë një dialog me Serbinë, në mënyrë që Serbia të kthejë Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK. Mirëpo, UNMIK-u, si administrues i besuar politik, nuk e kishte shfrytëzuar autoritetin e tij sovran, të akorduar me Rezolutën 1244, për të zgjidhur problemin e qytetarëve të Kosovës, si përfitues të administrimit të besuar politik, të cilëve u ishte mohuar e drejta në sigurimin

³⁴ Perritt, H. (2004), ‘Qëndrueshmëria Ekonomike dhe Statusi Final për Kosovën’. Në dispozicion në: <https://www.law.upenn.edu/journals/jil/articles/volume25/issue1/Perritt25U.Pa.J.Int%27Econ.L.259%282004%29.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

³⁵ Perritt, H. (2010), ‘Rruga Drejt Pavarësisë për Kosovën: Kronikë mbi Planin e Ahtisarit’ fq.65. Në dispozicion në: <https://www.cambridge.org/core/books/road-to-independence-for-kosovo/2E3130A862C3A4515C6F3C22A0D3C7FF> [Qasur më: 10 shtator 2019].

³⁶ Ish ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës

pensional dhe invalidor (një e drejtë, të cilën ata e kishin fituar në bazë të Nenit 163 të Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së). Janë ndërmarrë disa iniciativa jo politike për të zgjidhur çështjen në emër të popullit të Kosovës nga ana e Ombudspersonit Ndërkombëtar në Kosovë, z. Marek Nowicki me ministrin e Ministrisë së Punës, Punësimit dhe Politikave Sociale të Serbisë.³⁷ Në dy përgjigje të ndara ndaj pyetjeve të Ombudspersonit të Kosovës, në vitin 2003 dhe 2004, qeveria e Serbisë kishte dhënë mendimin se, ndër të tjera, sistemi ekzistues i Serbisë është i bazuar në programin e solidaritetit mes gjeneratave, ku pensionet aktuale paguhën nga kontributet pensionale aktuale. Meqë Serbia nuk ka pasur mundësi të mbledhë kontributet pensionale në Kosovë që nga viti 1999, ata shpjeguan se, për momentin, kanë ndërprerë pagesat e pensioneve për banorët e Kosovës të cilët e kishin të garantuar këtë të drejtë nga fondi pensional në të kaluarën. Ata po ashtu theksuan se pensionistët kontributdhënës kosovarë do të mund të marrin pensionet e tyre në të ardhmen, pa dhënë ndonjë datë të caktuar. Qeveria e Serbisë iu referua faktit se pensionistët kontributdhënës kosovarë janë duke marrë pensione përmes sistemit të ri të Kosovës të themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35 (Opinionit i Ministrisë për Çështje Sociale - Mišljenje Ministarstva za socijalna pitanja - nr. 181-01-126/2003 të datës 7 mars 2003, dhe Opinionit i Ministrisë së Punës, Punësimit dhe Politikave Sociale të Serbisë - Mišljenje Ministarstva rada, zapošljavanja i socijalne politike - nr. 182-02-20/2004-07 të datës 18 qershor të vitit 2004 marrë në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, e vitit 2012). Sipas tyre, kjo paraqiste një çështje serioze. Qeveria e Serbisë iu referua Nenit 119 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë i cili “parasheh që kur një pensionist ka të drejtë në dy apo më shumë pensione brenda territorit të Serbisë, vetëm njëri nga ato dy pensione mund të paguhet, në përputhje me preferencën e pensionistit”, duke pretenduar kështu se është e papranueshme që një person të gëzonte dy pensione me bazë të njëjtë. Kështu, ata pretenduan se nuk do të ishte e pranueshme të paguheshin pensionet. Po ashtu, qeveria e Serbisë

³⁷ KosovaKosovo.com (2005), ‘Forumi Shqiptaro-Serb për Këmbimin e Informatave’ fq. 50. Në dispozicion në: <http://kosovalive.org/wp-content/uploads/pdf/KosovoKosova.pdf> [Qasur më: 10 shtator 2019].

shpjegonte se detyrimet pensionale paraqesin një çështje politike, e cila nuk mund të zgjidhet unilateralisht nga Serbia, por duhet të jetë subjekt i “një zgjidhjeje politike, përmes negociatave”. Megjithatë, siç është shpjeguar në detaje në këtë studim, Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka vlerësuar se këto opinione të qeverisë së Serbisë nuk janë në përputhje me ligjet vendore, derisa GJEDNJ ka vlerësuar se opinionet janë në kundërshtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Në vitin 2010, ndër të tjera, Ministria e Financave e Serbisë kishte theksuar ky borxh do të ishte një barrë e madhe fiskale. Ata theksuan se “borxhi potencial që ndërlidhet me situata të ngjashme me ato të aplikantit do të ishte me të vërtetë shumë i lartë dhe se do të cenonte shumë stabilitetin fiskal të vendit”.³⁸ Sipas tyre, bazuar në të dhënat zyrtare të ofruara nga fondi pensional shuma totale e borxhit është vlerësuar të jetë 1,008,358,614 Euro, e cila është “më e vogël se 10% e shumës totale të rezervës në valutë të huaj të Serbisë”. Pas këtyre dy opinioneve të lartpërmendura të qeverisë së Serbisë, qeveria e Serbisë ka pretenduar se nuk ka pas ndonjë iniciativë institucionale nga pala Kosovare për të komunikuar me qeverinë e Serbisë mbi çështjen e pensioneve.

30. Neglizhenca dhe mungesa e dëshirës së UNMIK që në emër të popullit të Kosovës të iniciojë procesin për zgjidhjen e problemit lidhur me Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK shërben si evidencë se UNMIK ka dështuar të ushtrojë autoritetin sovran në plotëni, si administrues i besuar politik i Kosovës, dhe se ka dështuar të shërbejë dhe mbrojë interesat e popullit të Kosovës, si përfitues të administrimit të besuar politik. Rolin si administrues i besuar politik UNMIK-u e ka marrë në bazë të Rezolutës 1244, sipas të cilës është autorizuar që të ushtrojë sovranitetin në Kosovë. Dëshmia ligjore mbi ngurrimin e UNMIK që të veprojë si administrues i besuar politik i popullit të Kosovës ofrohet edhe në vendimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut në lëndën gjyqësore Tomë Krasniqi kundër UNMIK-ut.

³⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2012), ‘Grudic v. Serbia, Aktgjykimi i Strasbourgut’. Në dispozicion në: http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

31. Në vitin 2016, paditësi Tomë Krasniqi, banor i Komunës së Pejës (Kosovë), ka dorëzuar parashtresën ligjore kundër UNMIK-ut, ndër të tjera, lidhur me faktin që UNMIK-u ka dështuar të zgjidh problemin lidhur me fondin pensional dhe si rezultat i kësaj ka dështuar që paditësit t’ia mundësojë vazhdimin e marrjes së pensionit, duke pretenduar kështu se *“kjo është në kundërshtim me të drejtën e tij për shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tij sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).”*³⁹ Paditësi ka kontribuar në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të ish KSAK dhe në bazë të kësaj ka fituar të drejtën në pension, si e drejtë pronësore sipas kornizës ligjore të ish RSFJ. Të njëjtit, menjëherë pas themelimit të UNMIK-ut nën Rezolutën 1244, i është mohuar e drejta në pension pa ndonjë lajmërim paraprak ose shpjegim nga ana e qeverisë së Serbisë. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) e kundërshtoi pretendimin e paditësit, ndër të tjera, mbi bazën e asaj se *“mandati i UNMIK që ishte të lehtësonte procesin politik, në mënyrë që të zgjidhej çështja rreth statusit të Kosovës, nuk mund të interpretohej si detyrim për të gjetur një zgjidhje për problemin e pensioneve”,* duke pretenduar kështu se UNMIK nuk kishte mandat që të ushtrojë presion mbi autoritetet jashta Kosovës.⁴⁰ Sipas PSSP, gjetja e një zgjidhje për problemin e fondit pensional në Kosovë është një *“çështje politike”,* dhe se parakusht për zgjidhje janë *“gatishmëria dhe dëshira politike”,* si dhe *“funksionimi i kanaleve (administrative) të bashkëpunimit”.* Rrjedhimisht, çështja e pensioneve duhet të trajtohet në një dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga bashkësia ndërkombëtare. Në mungesë të dëshmive të ofruara nga PSSP lidhur me këtë pretendim, sipas opinionit të PKDNJ, edhe pse UNMIK në mënyrë implicite e pranon përgjegjësinë e vet për të ndërmarrë masa rreth suspendimit të pagesave të pensioneve, UNMIK nuk ka ndërmarrë masa konkrete për të mbrojtur të drejtën në pension të pensionistëve kontributdhënës në Kosovë, gjegjësisht të drejtën në pension të përfituesve të administrimit të besuar politik të UNMIK-ut. Si pasojë, PKDNJ rekomandoi që

³⁹ Paneli Këshilldhënës mbi të Drejtat e Njeriut (2016), ‘Krasniqi v. UNMIK’ pika 33, fq. 5. Në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/08_10%20Krasniqi%20FINAL%2017may16.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁴⁰ Paneli Këshilldhënës mbi të Drejtat e Njeriut (2016), ‘Krasniqi v. UNMIK’ pika 48, fq.8. Në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/08_10%20Krasniqi%20FINAL%2017may16.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

UNMIK “të pranojë dështimin e vet për të realizuar detyrimet e parapara me Nenin 9 dhe 11 të Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (PNDESHK) dhe t’i kërkojë falje paditësit”.

32. Paditësi po ashtu ka pretenduar se sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ “e drejta e tij në shfrytëzimin e qetë të pasurisë” është shkelur. Lidhur me këtë, sipas opinionit të PKDNJ, edhe pse UNMIK-u ka dështuar të ndërmarrë masa konkrete për të zgjidhur problemin lidhur me fondin pensional të vjetër, UNMIK ka ndërmarrë masa që të zgjidhë problemin e pensioneve në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. UNMIK ka miratuar Rregulloren nr. 2001/35 sipas të cilës është themeluar skema e re pensionale, e cila është operacionalizuar në vitin 2002. Rrjedhimisht, sipas PKDNJ, UNMIK nuk mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Megjithatë, duke ndjekur të njëjtin arsyetim të përdorur nga PKDNJ-ja lidhur me ankesën për trajtimin diskriminues (shih paragrafin tjetër) kjo shkelje është "ekskluzivisht e ngarkuar me autoritetet serbe" pasi që Fondi me bazë në Beograd ka ndaluar së paguari pensionet e pensionistëve shqiptarë të Kosovës përfitime të përlogaritura në bazë të kuadrit ligjor të ish RSFJ-së. Me fjalë tjera, janë autoritetet e Serbisë ato të cilat kanë shkelur të drejtën në pension, gjegjësisht të drejtën personale, të paditësit. Së dyti, për shkak të mospagesës së pensionit “kontribues” dhe për shkak të pamjaftueshmërisë së pensionit të marrë nga skema e re pensionale e Kosovës, paditësi është ankuar se e drejta e tij “në sigurim social dhe standard të mirëfilltë jetese në moshë të vjetër është shkelur sipas Neneve 9 dhe 11 të PNDESHK. Së treti, e drejta e paditësit që të jetë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues është shkelur sipas Nenit 3 të KEDNJ-së. Sipas gjetjeve të PKDNJ, e drejta në sigurim social dhe në standard të mirëfilltë jetese garantohen me PNDESHK, prandaj, Paneli e gjen UNMIK-un fajtor për shkeljen e Neneve 9 dhe 11 të PNDESHK. Duke pas parasysh këto gjetje, sipas opinionit të PKDNJ-së, nuk ka nevojë që të vlerësohet ankesa / parashtresa në bazë të Nenit 3 të KEDNJ.

33. Paditësi është ankuar se përderisa e drejta në pension i është mohuar pensionistëve kontributdhënës shqiptarë në Kosovë, pasi që të njëjtëve u është ndërprerë

tërësisht pagesa e pensioneve, Serbët që jetojnë në Kosovë kanë vazhduar të marrin pensionet e tyre në baza të rregullta. Lidhur me këtë, paditësi pretendon se ekziston një trajtim diskriminues në mes të pensionistëve shqiptarë dhe atyre serbë të Kosovës gjë që është në shkelje të Nenit 14 të KEDNj. Megjithatë, në përkrahje të UNMIK, PSSP ka shpjeguar se UNMIK nuk ka “juridiksion *ratione personae*” mbi parashtresën lidhur me praktikat diskriminuese në zgjedhjen e përfituesve dhe pagesën e pensioneve. Sipas vendimit të PKDNJ-së, pretendime / akuza të tilla mbi trajtimin diskriminues të pensionistëve shqiptarë të Kosovës nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë e UNMIK dhe se një gjë e tillë është “përgjegjësi vetëm e autoriteteve të Serbisë”, sepse është Fondi pensional me bazë në Beograd ai i cili gjatë zgjedhjes dhe pagesës së pensioneve është duke diskriminuar pensionistët shqiptarë të Kosovës të cilët këtë të drejtë e kanë fituar në bazë të kornizës ligjore të ish RSFJ-së. Si përfundim, qeveria e Serbisë është ajo që duhet të jap llogari për diskriminim ndaj pensionistëve shqiptarë të Kosovës dhe trajtimin e favorizuar të pensionistëve serbë të Kosovës.

Vlerësimi i dëmeve në para dhe jo-pasurore që rrjedhin nga suprimimi i BVISPI të ish KSAK dhe nga suspendimi i pagesës së pensioneve nga Serbia

34. Duke marrë parasysh se “*drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”, negociatat mbi dëmshpërblimet e luftës në lidhje me Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK, por jo të kufizuara vetëm në të, janë të ndërlidhura me të ardhmen e qytetarëve të Kosovës më shumë se me të kaluarën. Kjo nënkupton që dëmshpërblimet e luftës, para së gjithash, kanë të bëjnë me “*vënien e drejtësisë në vend*” për viktimat. Prandaj, përveç vlerësimit të dëmeve në para që rrjedhin nga shuarja dhe përvetësimi, si dhe suspendimi i pagesave të pensioneve për pensionistët kontributdhënës nga ana e Serbisë, nevojitet edhe vlerësimi i dëmeve jo-monetare dhe kostove tjera që ndërlidhen me to.

35. Në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, si pjesë të argumenteve të saj, qeveria e Serbisë i ka ofruar GJEDNJ-së një vlerësim *“të shumës totale të borxhit potencial të Serbisë të ndërlidhur me situatat e ngjashme si kjo e aplikantit”*.⁴¹ Qeveria e Serbisë ka argumentuar se Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Serbisë ka ofruar të dhëna se *“shuma totale në pyetje është vlerësuar të jetë rreth 1,008,358,614 Euro, përderisa Ministria e Financave e Serbisë vet e kishte vlerësuar këtë shumë të jetë rreth 1,050,468,312 Euro...”*⁴². Nga kjo shihet se qeveria e Serbisë i është referuar dy vlerësimeve të ndryshme të shumës totale të borxhit potencial të Serbisë lidhur me Sigurimin Pensional dhe Invalidor të qytetarëve të Kosovës. Njëri vlerësim është kalkuluar nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Serbisë, kurse tjetri nga Ministria e Financave e Serbisë. Mirëpo, asnjëra palë nuk ka ofruar detaje rreth metodave që janë përdorur, periudhës kohore në pyetje, numrit të pensionistëve kontributdhënës, apo shumës së përfitimeve nga sigurimi pensional ose invalidor të përdorura për vlerësimin e borxhit potencial. Siç përshkruhet në detaje më poshtë, kjo vlerë është shumë më e ulët sesa shuma totale e borxhit potencial prej 2,045,520,750 Euro e vlerësuar në bazë të të dhënave ekzistuese për periudhën 1999-2016.

36. Në dokumentin e quajtur “Dialogu i Brukselit – Temat për Fazën e Ardhshme” të përgatitur nga Kabineti i ish zv. Kryeministres së Republikës së Kosovës, znj. Edita Tahiri, për nevojat e Dialogut të Brukselit në mes të qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Republikës së Serbisë, të lehtësuar nga BE, ekipi i referohet shënimeve origjinale të Qendrës Elektronike të Kontabilitetit të ish BVISPI të datës 31.12.1998.⁴³ Sipas këtij burimi (më tutje burimi i parë), në Tabelën 1 është paraqitur numri total i përfituesve të pensioneve, gjithsej 89,135, të cilët janë ndarë në tri kategori: 1) 33,308 pensionistë të moshës, 2) 28,034 pensionistë familjarë dhe 3) 25,045 pensionistë invalidor. Po ashtu, kanë ekzistuar edhe 1,266 përfitues të

⁴¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2012), ‘Grudic v. Serbia, Aktgjykimi i Strasbourgut’ fq. 11. Në dispozicion në: http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p-br-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁴² Po aty.

⁴³ Zyra e Kryeministrit (2014), ‘Dialogu i Brukselit – Temat për Fazën e Ardhshme’. E qasshme në bazë të kërkesës.

pensionit të lëndimeve trupore dhe 1,252 përfitues të pensionit për ndihmë dhe kurim.⁴⁴

37. Siç është paraqitur në Tabelën 1, ekziston një dallim i vogël në mes të të dhënave të raportuara nga Kabineti i ish zv. Kryeministres së Republikës së Kosovës dhe të dhënave të ofruara nga Regjistri i Fondit të Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të ish KSAK mbi Pensionistët dhe Invalidët Kontributdhënës për vitin 1998 që Federata e Pavarur e Sindikatave të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës e ka pranuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (më tutje burimi i dytë). Ky dallim i vogël në mes të burimeve ka të bëjë me: 1) numrin e pensionistëve të invaliditetit i cili është për dy pensionistë më i madh sesa ai i raportuar nga burimi i parë, 2) numrin e pensionistëve familjarë i cili është për një pensionist më i madh sesa ai i raportuar nga burimi i parë, 3) numrin e pensionistëve me invaliditet të nivelit të dytë dhe të tretë i cili nuk është raportuar nga burimi i parë. Rrjedhimisht, numrat total të përfituesve të raportuar dallojnë pak në mes të këtyre dy burimeve; burimi i dytë raporton se numri total i përfituesve të pensioneve është 88.901.

Tabela 1: Numri i përfituesve sipas llojeve të pensioneve, të shprehur në përqindje, sipas burimeve të të dhënave, për vitin 1998

Lloji i pensionit	Numri i përfituesve*	% e totalit të përfituesve	Numri i përfituesve**	% e totalit të përfituesve
Pensioni i moshës	33,308	37.46	33,308	37.37
Pensioni i invaliditetit	25,045	28.17	25,042	28.10
Pensioni familjar	28,034	31.53	28,033	31.45
Ndihmë dhe kurativë	1,252	1.41	1,252	1.40
Lëndime trupore	1,266	1.42	1,266	1.42
Pension i invaliditetit –	n/a	n/a	224	0.25

⁴⁴Kur të mblidhen këto shifra të dhënë sipas kategorive numri total i përfituesve nuk përputhet me numrin total të përfituesve të raportuar në këtë dokument.

niveli i dytë dhe i tretë i invaliditetit				
Total	88,905	100	89,125	100

* Burimi 1: numrat e raportuar në dokumentin e titulluar “Dialogu i Brukselit – Temat për Fazën e Ardhshme” të përgatitur nga Kabineti i ish zv. Kryeministres së Republikës së Kosovës, znj. Edita Tahiri për nevojat e Dialogut të Brukselit.

**Burimi 2: Regjistri i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK mbi Pensionistët dhe Invalidët Kontributdhënës për vitin 1998 (marrë nga Federata e Pavarur e Sindikatave të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës)

38. Në Tabelën 2 janë dhënë shumat e përfitimeve pensionale dhe invalidore sipas llojit të pensionit dhe si përqindje e totalit të paguar ndaj të gjithë pensionistëve kontributdhënës të Kosovës për vitin 1998, pavarësisht nga përkatësia etnike. Shuma totale e përfitimeve për vitin 1998 është vlerësuar të jetë 75,243,465 Euro. Përafërsisht gjysma e kësaj shume është paguar në formën e pensioneve të moshës, derisa një e treta u pagua në formën e pensioneve të invaliditetit. Shuma e pensioneve familjare paraqet rreth një të katërtën e shumës totale.

Tabela 2: Numri i përfituesve dhe shuma e përfitimeve, të shprehur në përqindje sipas llojeve të pensioneve (këtu nuk përfshihet kategoria “Pensioni i invaliditetit – niveli i dytë dhe i tretë”), për vitin 1998

Lloji i pensionit	Numri i përfituesve	% e totalit të përfituesve	Përfitimet pensionale në EUR*	% e totalit të përfitimit pensional
Pensioni moshës	33,308	37.47	35,755,764.39	47.52
Pensioni i invaliditetit	25,042	28.17	21,076,407.31	28.01
Pensioni familjar	28,033	31.53	18,000,190.29	23.92
Ndihmë dhe	1,252	1.41	321,249.72	0.43

kurativë				
Lëndime trupore	1,266	1.42	89,853.27	0.12
Total	88,901	100	75,243,464.98	100

Burimi: Regjistri i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK mbi Pensionistët dhe Invalidët Kontributdhënës për vitin 1998 (marrë nga Federata e Pavarur e Sindikatave të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës)

Shënim: *Vlera së pari është këmbyer në valutën Markë Gjermane (DM) dhe më pas është këmbyer në valutën Euro (EUR), duke përdorur kursin e këmbimit 1/2 për EUR/DM.

39.Struktura e përfituesve dhe përfitimet e tyre përkatëse sipas përkatësisë etnike është raportuar në Tabelën 3. Shumica e pensionistëve kontributdhënës ishin shqiptarë etnikë ose jo serbë. Mirëpo, shumica e përfitimeve të tyre të shprehura në përqindje është pak më e vogël sesa numri i tyre i shprehur në përqindje që ndikon që shumica mesatare e përfitimit pensional të tyre të jetë më e vogël. Kështu, vlera mesatare e përfitimeve pensionale dhe invalidore për shqiptarët dhe jo serbët ishte rreth 18% më e ulët se ajo e serbëve dhe malazezëve dhe 6% më e ulët se shumica mesatare e përfitimit pensional dhe invalidor e llogaritur për të gjitha etnitë së bashku. Meqë formula për llogaritjen e kontributeve dhe përfitimeve pensionale, ndër të tjera, merr për bazë nivelin e të ardhurave personale, ky dallim në vlerat mesatare të përfitimeve mund të jetë rezultat i asaj që shqiptarët dhe jo serbët kanë pasur të ardhura personale më të ulëta. Një gjë e tillë mund edhe të jetë rezultat i asaj që shqiptarët dhe jo serbët ishin të diskriminuar kur ishte fjala për vende pune me të ardhura të larta personale në tregun e punës në Kosovë.

Tabela 3: Numri i përfituesve dhe shuma e përfitimeve të pensionit sipas nacionalitetit sa i përket 31.12.1998

	<i>Numri i përfituesve</i>	<i>Numri i përfituesve, në përqindje</i>	<i>Shuma e përfitimeve në DM</i>	<i>Shuma e përfitimeve në përqindje</i>	<i>Shuma mesatare e përfitimeve</i>	<i>Diferenca mes mesatares së etnisë përkatëse dhe mesatares për të gjitha etnitë, në përqindje *</i>
<i>Shqiptarë dhe të tjerë</i>	61,705	69.23	7,001,203	64.98	113.46	-6
<i>Serbë dhe Malazezë</i>	27,430	30.77	3,773,265	35.02	137.56	+14
<i>Të gjitha etnitë</i>	89,135	100	10,774,468	100	120.88	0

Burimi: Regjistri i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK mbi Pensionistët dhe Invalidët Kontributdhënës për vitin 1998 (marrë nga Federata e Pavarur e Sindikatave të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës) dhe Fondi i BVI së Beogradit, Selia në Prishtinë

Shënim: *Diferenca është llogaritur duke pjesëtuar shumën mesatare të përfitimeve me shumën mesatare të përfitimeve për të gjitha etnitë dhe shumëzuar me 100

40. Në Tabelën 4, janë vlerësuar shumat vjetore të borxhit potencial të Serbisë ndaj pensionistëve kontributdhënës shqiptarë dhe jo serbë në Kosovë në bazë të të dhënave zyrtare mbi të ardhurat mesatare vjetore neto të ofruara nga Zyra Statistikore e Republikës së Serbisë (ZSRS) për periudhën 2008-2017, të dhënat zyrtare mbi kurset e këmbimit në mes të Dinarit të Serbisë dhe Euros për periudhën 2002-2017 të ofruara nga Banka Kombëtare e Serbisë (BKS), si dhe të dhënat e ofruara nga një zyrtar i FPSP mbi pensionet mesatare mujore dhe mbi vlerat e munguara për pagën mesatare neto në Serbi, si dhe duke marrë për bazë numrin

61,705 si numri total i përfituesve pensional për secilin vit⁴⁵, si sasi vjetore e borxhit potencial të Serbisë për pensionistët kontribues shqiptarë dhe jo-serbë të Kosovës.

Tabela 4: Paga mesatare vjetore neto, pensioni mesatare mujor dhe borxhi pensional i Serbisë për periudhën 1999-2018⁴⁶⁴⁷⁴⁸⁴⁹⁵⁰

Viti	Të ardhurat mesatare neto vjetore në Dinar	Norma zyrtare e këmbimit të Dinarit me Euro	Të ardhurat mesatare neto mujore në Euro (kolona 2/kolona 3)	Pensioni mesatar mujor në Euro	Norma e zëvendësimit të pensionit në përqindje (kolona 4/ kolona 5)	Borxhi total pensional në Euro (kolona 5* 12 muaj * 61,705 përfitues)
1998						
1999			210	94.5	45	69,973,470
2000			310	140	45.2	103,664,400
2001			90	41	45.6	30,358,860
2002		60.69	152	115	76	85,152,900
2003		65.12	177	130	73.4	96,259,800
2004		72.69	187	132	70.1	97,740,720
2005		82.99	210	148	70.5	109,588,080
2006		84.11	258	159	61.2	117,733,140

⁴⁵Duhet të theksohet se për shkak të mungesës së të dhënave numri 61,705 përfitues është dashur të përdoret si numri i përgjithshëm i përfituesve për secilin vit për kalkulim të përafërt të borxhit total të Serbisë lidhur me sigurimin pensional dhe invalidor të pensionistëve kontribut pagues shqiptarë dhe jo serbë në Kosovë.

⁴⁶Periudha 2006-2016 bazohet në kalkulime vetanake, duke u shërbyer me burimet e raportuara nën tabelë. Pjesa tjetër e vlerësimeve është llogaritur nga një përfaqësues i FPSP.

⁴⁷Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë (2011), 'Vjetari Statistikor 2011'. Në dispozicion në: <http://www.stat.gov.rs/en-US/publikacije/?d=2&r> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁴⁸Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë (2015), 'Vjetari Statistikor 2015'. Në dispozicion në: <http://www.stat.gov.rs/en-US/publikacije/?d=2&r> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁴⁹Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë (2017), 'Vjetari Statistikor 2017'. Në dispozicion në: <http://www.stat.gov.rs/en-US/publikacije/?d=2&r> [Qasur më: 10 shtator 2019].

⁵⁰ Banka Kombëtare e Serbisë (2019). Në dispozicion në: https://www.nbs.rs/internet/english/scripts/kl_prosecni.html [Qasur më: 10 shtator 2019].

2007		79.96	347	188	52.7	139,206,480
2008	392952	81.44	402	238	60.2	176,229,480
2009	380796	93.95	338	231	70.7	171,046,260
2010	409704	103.04	331	211	67.7	156,237,060
2011	455712	101.95	372	228	53	168,824,880
2012	496524	113.13	366	221	64.2	163,641,660
2013	527184	113.14	388	230	59	170,305,800
2014	534360	117.31	379	222	67.3	164,382,120
2015	533184	120.73	368	207	59.3	153,275,220
2016	553164	123.12	374	205	54.8	151,794,300
2017	574716	121.34	395	n/a	n/a	n/a
2018	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total						2,325,414,630

41. Në Tabelën 5, vlera totale e borxhit potencial të Serbisë është raportuar sipas llojit të borxhit.

Dëmi në para

Sipas aktgjykimit/vendimit të GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë (2012), sipas Tabelës 4, në lidhje me dëmet në para, Serbia i ka borxh pensionistëve kontributdhënës shqiptarë dhe jo serbë shumën e vlerësuar rreth 2,325,414,630 Euro për periudhën 1999-2016. Në mungesë të të dhënave, shuma e vlerësuar e borxhit total nuk përfshin borxhin për periudhën 2017-2018 (viti kur është bërë vlerësimi). Po ashtu, kjo shumë nuk përfshin pensionet që nuk iu kanë paguar pensionistëve kontribut pagues gjatë vitit 1998 në zonat e luftës.

Duhet të theksohet fuqishëm se kjo shumë totale e borxhit nuk përfshin punëtorët, të cilët kanë paguar kontribute të detyrueshme në BVISPI të ish KSAK për më pak se 15 vite, gjegjësisht që nuk kanë arritur ta plotësojnë kriterin për stazhin pensional për shkak

të pushimit të tyre të jashtëligjshëm nga puna nga ana e regjimit serb në atë kohë. Mirëpo, sipas ligjeve serbe, kjo kategori mund ta blejë stazhin ex-post dhe të fitojë të drejtën në sigurimin pensional.

Dëmi jo-pasuror

Sipas aktgjykimit / vendimit të GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, në lidhje me dëmin jo-pasuror, Serbia iu ka borxh pensionistëve kontribut pagues, gjegjësisht secilit nga 61,705 pensionistët kontribut pagues një vlerë prej EUR 7,000, plus ndonjë tatim që mund të ngarkohet në ta. Në bazë të kësaj, shuma totale e borxhit potencial në lidhje me dëmin jo-pasuror vlerësohet të jetë 431,935,000 Euro ($61,705 \times 7,000$ Euro = 431,935,000 Euro).

Kostot dhe shpenzimet

Sipas aktgjykimit / vendimit të GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, Serbia iu ka borxh pensionistëve kontributdhënës, gjegjësisht secilit nga 61,705 pensionistët kontributdhënës një vlerë prej EUR 1,500, plus ndonjë tatim që mund të ngarkohet në ta. Në bazë të kësaj, shuma totale e borxhit potencial në lidhje me kostot dhe shpenzimet vlerësohet të jetë 92,557,500 Euro ($61,705 \times 1,500$ Euro = 92,557,500 Euro).

Interesi statutor

Sipas aktgjykimit / vendimit të GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, duke iu referuar Aktit të Interesit Statutor Nr. 31/11 të Republikës së Serbisë, Serbia duhet t'i paguaj "interes statutor (do të paguhet) që nga data e mbushjes së afatit të ndonjë pretendimi të njohur monetar në dinar serbë deri në datën e zgjidhjes së tij" (Neni 1), i cili "duhet të kalkulohet në bazë të indeksit të çmimeve të konsumatorëve plus 0.5% tjera në muaj".

Punëtorët, të cilët kanë kontribuar për më pak se 15 vite në BVISPI të ish KSAK

Shuma totale e borxhit potencial nuk përfshin borxhin për periudhën 2017-2018 (viti kur është bërë vlerësimi), dhe borxhin për pensionet që nuk janë paguar gjatë vitit

1998 në zonat e luftës. Duhet të theksohet fuqishëm që kjo shifër nuk përfshin as punëtorët të cilët kanë paguar kontribute të detyrueshme për më pak se 15 vite, gjegjësisht që nuk kanë arritur ta plotësojnë kriterin për stazhin pensional, për shkak të pushimit të tyre të jashtëligjshëm nga puna nga ana e regjimit serb në atë kohë.

Tabela 5: Shuma e borxhit potencial të Serbisë në Euro ndaj 61,705 pensionistëve kontribut pagues, sipas llojit të borxhit për periudhën 1999-2016⁵¹

Lloji i borxhit	Shuma në EUR
Dëmi në para	2,325,414,630
Dëmi jo-pasuror	431,935,000
Kostot dhe shpenzimet	92,557,500
Totali	2,849,907,130
Interesi statutor	Indeksi zyrtar i Çmimeve të Konsumatorëve në Republikën e Serbisë + 0.5% të tjera në muaj

42. Si përfundim, shuma totale e borxhit potencial të Serbisë ndaj pensionistëve kontributdhënës në lidhje me dëmin në para, dëmin jo-pasuror, kostot dhe shpenzimet, për periudhën 1999-2016 vlerësohet të jetë rreth 2,849,907,130 Euro, duke mos përfshirë këtu interesin statutor, borxhin për periudhën 2017-2018, borxhin ndaj pensionistëve kontributdhënës që kanë jetuar në zonat e luftës gjatë vitit 1998, si dhe duke mos përfshirë borxhin ndaj atyre që kanë paguar kontribute të detyrueshme për më pak se 15 vite në BVISPI të ish KSAK.

⁵¹ Periudha 2008-2016 bazohet në kalkulime vetanake, duke u shërbyer me burimet e raportuara poshtë tabelës. Pjesa tjetër e vlerësimeve është llogaritur nga një përfaqësues i FPSP.

Përfundimet

- 43.** Sipas Nenit 53, Nenit 163 dhe Nenit 281 të Kushtetutës së ish RSFJ-së të vitit 1974, Ligjit mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor të ish RSFJ-së të vitit 1982, dhe Neneve 50, 51 dhe 52 të Kushtetutës së ish KSAK të vitit 1974, ish KSAK ka miratuar Ligjin mbi Bashkësitë Vetëqeverisëse të Interesit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të vitit 1976 dhe Ligjin mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të vitit 1983. Ligji i vitit 1976 ofronte bazën ligjore për themelimin dhe veprimin e Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor (BVISPI). BVISPI, si një subjekt juridik i pavarur, ka menaxhuar dhe administruar sistemin e sigurimit social në bazë të parimit të reciprocitetit dhe solidaritetit dhe punës së kaluar në territorin e ish KSAK. Për të kompletuar rregullimin e fushës së sigurimit pensional dhe invalidor, ish KSAK miratoi Ligjin e vitit 1983, i cili ishte në përputhje me Ligjin mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor të ish RSFJ-së të vitit 1982. Ligji KSAK i vitit 1983 parashikoi të drejtën e sigurimit të pensionit dhe të paaftësisë si një e drejtë themelore për territorin e ish KSAK.
- 44.** Sipas këtyre dy ligjeve, të cilat ishin në përputhje të plotë me Kushtetutën e ish RSFJ-së të vitit 1974 dhe me Kushtetutën e ish KSAK të vitit 1974, e drejta mbi sigurimin pensional dhe invalidor rregullohej si një e drejtë themelore e njeriut, e cila ishte fituar në bazë të punës dhe kontributeve të detyrueshme nga të ardhurat personale (Neni 1, Neni 3, Neni 5, Neni 8, Neni 108 i Ligjit të ish KSAK të vitit 1983) dhe si e tillë (i) nuk mund të transferohej te një person tjetër (Neni 5, Ligji mbi Parimet e Sigurimit Pensional dhe Invalidor i RSFJ i vitit 1982) dhe (ii) nuk mund të shfuqizohej, përveç kërkesave në shuma të papaguara dhe pretendimeve të papaguara (Neni 5, Ligji mbi Parimet e Sigurimit Pensional dhe Invalidor i ish RSFJ-së i vitit 1982; Neni 9, Ligji i ish KSAK i vitit 1983).
- 45.** Pas shfuqizimit të dhunshëm të statusit të Kosovës si Krahinë Autonome Socialiste në bazë të Ligjit mbi Pushimin e Punës të Kuvendit të KSAK dhe të Këshillit

Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK, u shua edhe BVISPI e ish KSAK në bazë të Ligjit të Serbisë mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të vitit 1992. Sipas Ligjit të Serbisë mbi BVISPI të vitit 1992, të gjitha pasuritë, mjetet, inventari, të DREJTAT, por edhe OBLIGIMET e BVISPI të ish KSAK i ka përvetësuar (uzurpuar) BVISPI e Serbisë. Rrjedhimisht, BVISPI e ish KSAK u integrua në BVISPI të Serbisë.

46.Duhet të theksohet fuqishëm se sipas ligjit BVISPI e Serbisë mori të gjitha OBLIGIMET e BVISPI të ish KSAK, duke përfshirë këtu obligimet ligjore për të paguar sigurimin pensional dhe invalidor për pensionistët kontributdhënës. Serbia i respektoi këto obligime ligjore deri në periudhën 1998/99, por jo në plotëni, dhe me themelimin e UNMIK-ut e suspendoi pagesën e pensioneve për pensionistët kontributdhënës shqiptarë dhe jo-serbë. Përmes suspendimit të pagesave Serbia ka shkelur të drejtën themelore mbi sigurimin pensional dhe invalidor që definohet si e drejtë themelore e njeriut, e cila nuk mund të transferohet dhe nuk mund të shfuqizohet, sipas ligjeve të ish RSFJ-së, ish KSAK, si dhe ligjeve në fuqi të Serbisë.

47.Duke iu referuar dokumenteve ligjore të ish RSFJ-së, ish KSAK, dokumenteve ligjore në fuqi në Serbi dhe dokumenteve ligjore ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën në pension, përfaqësuesit e Federatës së Pensionistëve, shpjegojnë se Serbia ka shkelur të drejtën e tyre themelore nga sigurimi pensional dhe invalidor, përmes kësaj Serbia i ka penguar ata që të shfrytëzojnë në mënyrë të qetë pasurinë e tyre, dhe se Serbia i ka diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike duke vazhduar t'ua paguaj pensionet vetëm serbëve dhe malazezëve në Kosovë. Ata vlerësojnë se problemi i pensionistëve kontributdhënës nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë nga UNMIK-u dhe qeveria e Kosovës. Po ashtu, ata insistojnë se vazhdimi i pagesës së pensioneve për secilin pensionist veç e veç është e vetmja zgjidhje e pranueshme, e drejtë dhe ligjore, dhe jo arbitrare, sepse e drejta në pension duke qenë një e drejtë themelore, e cila është e patjetërsueshme, nuk mund të jetë subjekt i ndonjë zgjidhjeje politike.

- 48.** Sipas vlerësimeve vetanake, të cilat bazohen në aktgjykimin/vendimin e GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë⁵² dhe në kalkulimet e një zyrtari të FPSP (për periudhën për të cilën kanë munguar të dhënat), shuma totale e borxhit potencial të Serbisë ndaj pensionistëve kontributdhënës në lidhje me dëmet në para dhe jo-pasurore, si dhe me kostot dhe shpenzimet, për periudhën 1999-2016 është rreth 2,849,907,130 Euro, pa përfshirë këtu interesin statutor, borxhin për periudhën 2017-2018, borxhin ndaj disa pensionistëve kontributdhënës në zonat e luftës në vitin 1998, dhe borxhin ndaj atyre të cilët kanë paguar kontributet e detyrueshme për më pak se 15 vite në BVISPI të ish KSAK.
- 49.** Sërish, duhet të theksohet fuqishëm që kjo shumë nuk përfshinë borxhin që Serbia ia ka atyre të cilët kanë paguar kontributet e detyrueshme për më pak se 15 vite në BVISPI të ish KSAK. Prandaj, kjo çështje duhet të trajtohet me seriozitet dhe qeveria e Kosovës duhet të mbledhë të dhëna mbi këtë kategori të pensionistëve, në mënyrë që të vlerësohet borxhi potencial ndaj tyre nga ana e Serbisë para se të fillojë negociimi mbi borxhin ndaj pensionistëve kontributdhënës që e kanë fituar të drejtën në pension.

Rekomandimet

- 50.** Duke u bazuar në konkludimet e ofruara në pjesën e mëparshme, sidomos aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Serbia duke e shuar dhe përvetësuar BVISPI të ish KSAK në mënyrë të jashtëligjshme dhe duke suspenduar pagesën e pensioneve ndaj shqiptarëve dhe jo-serbëve në Kosovë, ka shkelur të drejtën themelore nga sigurimi pensional dhe invalidor të pensionistëve kontributdhënës dhe i ka penguar të njëjtit në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tyre. Për të çuar drejtësinë në vend, rekomandohet që:

⁵² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2012), 'Grudic v. Serbia, Aktgjykimi i Strasbourgut'. Në dispozicion në: http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/presude/u-odnosu-na-rs/grudic-protiv-srbije-p-br.-31925-08/Grudic_p_3192508_eng.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

- i.** Republika e Serbisë zyrtarisht ta pranojë se e drejta në pension është e drejtë themelore e fituar në bazë të punës dhe kontributeve të detyrueshme dhe se si e tillë është e rregulluar si një e drejtë themelore e njeriut e cila (i) nuk mund të transferohet te një person tjetër dhe (ii) nuk mund të parashkruhet, përveç kërkesave në shumën të papaguara dhe pretendimeve të papaguara;
- ii.** Republika e Serbisë zyrtarisht ta pranojë përgjegjësinë për dëmin në para dhe dëmin jo-pasuror që ia ka shkaktuar pensionistëve kontributdhënës;
- iii.** Republika e Serbisë t’iu kërkojë publikisht falje pensionistëve kontributdhënës për dëmin në para dhe dëmin jo-pronësor që ua ka shkaktuar përmes suspendimit të jashtëligjshëm nga ana e saj (Republikës së Serbisë) të pagesave të sigurimit pensional dhe invalidor;
- iv.** Republika e Serbisë zyrtarisht ta pranojë detyrimin e saj ligjor, politik, si dhe moral për të kompensuar pensionistët kontributdhënës për të gjitha dëmet në para dhe dëmet jo-pasurore sipas aktgjykimit/vendimit të GJEDNJ-së në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë. Përmes kësaj, Republika e Serbisë duhet që për secilin rast të paguaj (i) në lidhje me dëmin jo-pasuror, 7,000 Euro, plus ndonjë tatim që mund të ngarkohet në ta, (ii) në lidhje me kostot dhe shpenzimet, 1,500 Euro, plus ndonjë tatim që mund të ngarkohet në ta, dhe (iii) në lidhje me dëmin në para, pensionet e kalkuluara në baza individuale, së bashku me interesin statutor për tërë periudhën “të kalkuluar në bazë të indeksit të çmimeve të konsumatorëve plus 0.5% tjera në muaj”.
- v.** Republika e Serbisë, në bazë të aktgjykimit/vendimit të GJEDNJ-së⁵³ të ndërmerr “të gjitha masat e duhura që të sigurojë se autoritetet kompetente të Serbisë të zbatojnë të gjitha ligjet relevante, në mënyrë që të sigurohet pagesa e

⁵³ Po aty.

pensioneve dhe borxheve tjera në pyetje, duke pas parasysh se disa procedura verifikuese administrative dhe/apo faktike të arsyeshme dhe të shpejta janë të nevojshme në këtë rast”.

- vi.** Republika e Serbisë, në bazë të Rekomandimit nr. 5, të pajtohet për një plan kohor mbi ekzekutimin në plotëni të pagesave.
- vii.** Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë mos të turbullojnë/përziejnë çështjen e pensionistëve kontributdhënës me çështjet politike ose çështjet tjera, të cilat janë subjekt i negociatave, por të pranojnë në mënyrë eksplicite që e drejta në sigurimin pensional dhe invalidor është një e drejtë themelore e njeriut, sipas dokumenteve ligjore të ish RSFJ, ish KSAK, të ligjeve në fuqi të Republikës së Serbisë dhe dokumenteve ligjore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, kjo çështje duhet të zgjidhet për secilin pensionist kontribut pagues veç e veç.
- viii.** Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë të pajtohen për identifikimin e të gjithë pensionistëve kontributdhënës, të cilët kanë paguar kontribute të detyrueshme në BVISPI të ish KSAK për më pak se 15 vite, por të cilët ishin pushuar nga puna jashtëligjshëm, dhe të njëjtit ta trajtojnë këtë kategori të pensionistëve në bazë të ligjeve të ish RSFJ dhe ish KSAK.
- ix.** Qeveria e Kosovës të shfrytëzojë të gjitha dokumentet relevante dhe të duhura për të zhvilluar argumentet e saj gjatë negociimit në emër të qytetarëve të vet në Dialogun e Brukselit.
- x.** Lehtësuesi në Dialogun e Brukselit, gjegjësisht BE, si dhe komuniteti ndërkombëtar të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t’u siguruar që Republika e Serbisë, sipas aktgjykimit/vendimit të GJEDNJ-së, të pajtohet “që të ndërmerr të gjitha masat e duhura që të sigurojë se autoritet kompetente të Serbisë të zbatojnë të gjitha ligjet relevante, në mënyrë që të sigurohet pagesa e pensioneve dhe borxheve tjera në pyetje, duke pas parasysh se disa procedura

verifikuese administrative dhe/apo faktike të arsyeshme dhe të shpejta janë të nevojshme në këtë rast.”

- xi.** Qeveria e Kosovës, sipas kërkesës së pensionistëve kontributdhënës, të merret seriozisht me ndryshimet dhe plotësimet shtesë të Ligjit nr. 04/L-101 mbi Fondin PENSIONAL të Kosovës, për t’u siguruar që pensioni bazik dhe shtesa prej 35 Euro të pensionit të pranuar nga pensionistët kontributdhënës të zëvendësohet me termin “asistencë sociale për pensionistët kontributdhënës”.

Anekset

Aneksi A Sigurimi Social në ish RSFJ para Kushtetutës së RSFJ të Vitit 1974

Sipas Ligjit mbi Sigurimin Social të Punëtorëve, të Punësuarve dhe Shërbyesve Civil të miratuar në vitin 1946 nga ish RSFJ, ishte përgjegjësi e qeverisë federal që të sigurojë punëtorët, të punësuarit dhe zyrtarët. Në kuadër të këtij sistemi të sigurimit social, kontributet mblidheshin nga punëdhënësit dhe punëtorët, derisa qeveria federale ishte GARANTUESI i të gjitha të drejtave dhe përfitimeve nga sigurimi social, meqë financimi i sistemit ishte rregulluar përmes buxhetit shtetëror.⁵⁴ Instituti Shtetëror për Sigurimin Social, si person juridik, operonte me sistemin, i cili menaxhohej dhe mbikqyrej nga Ministria e Punës e ish RSFJ-së.

Pas miratimit të urdhëresës administrative mbi Themelimin e Institutit për Sigurim Social dhe mbi Menaxhimin e Përkohshëm të Burimeve të Sigurimit Social të vitit 1952 filloi një periudhë e re në fushën e sigurimit social në ish RSFJ-së. Në vitin në vazhdim, duke pas për qëllim plotësimin e sistemit të mirëqenies sociale urdhëresa shtesë administrative u miratuan, duke përfshirë këtu Urdhëresën Administrative mbi Financimin e Sigurimit Social të vitit 1953 dhe Urdhëresën Administrative mbi Organizimin e Sigurimit Social të vitit 1955. Përmes këtyre urdhëresave administrative sistemi i sigurimit social deri në një masë u decentralizua, meqë disa përgjegjësi në fushën e sigurimit social iu transferuan instituteve për sigurim social të themeluara në republikat dhe krahinat e ish RSFJ-së.

Sipas Kushtetutës së RSFJ të vitit 1963, u realizuan zhvillime të reja në fushën e sigurimit social. Ligji mbi Sigurimin Pensional, ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Sigurimin Shëndetësor, si dhe ndryshimet në Ligjin mbi Sigurimin Invalidor u miratuan, ku sigurimin social u konsiderua si një institucion i sigurimit reciprok i të gjithë njerëzve punonjës. Pas ndryshimeve të vitit 1968 dhe 1971 të Kushtetutës së RSFJ, në dokumentet ligjore termi “sigurim social” u zëvendësua me termin “siguri sociale” i cili term kishte një kuptim më të gjerë. Në vitin 1972, RSFJ miratoi Ligjin nr. 35/72 mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi

⁵⁴Instituti i Sigurimeve Sociale (2019), ‘Historia’. Në dispozicion në: <http://www.zso.gov.rs/english/istorijat.htm> [Qasur më: 18 shtator 2019].

Pensional dhe Invalidor,⁵⁵ i cili parashihte që republikat të zhvillonin infrastrukturën e tyre ligjore për përshtatjen e Ligjit ndaj nevojave dhe kapaciteteve të tyre specifike. Kjo karakterizoi fundin e sistemit të unifikuar të sigurimit social, i cili përcaktonte të drejtat dhe detyrimet në nivel federal.

Një mori ndryshimesh u bënë gjatë periudhës 1952-1972 në infrastrukturën ligjore që kishin për qëllim plotësimin e rregullimit të sigurisë sociale dhe që mundësuan decentralizimin e sistemit të sigurisë sociale, duke transferuar pushtetin në fushën e sigurisë sociale nga niveli federal në nivel të republikave dhe krahinave. Megjithatë, sistemi i ri, edhe pse në masë të madhe ishte decentralizuar, ishte ndryshe nga sistemi vetëqeverisës i sigurisë sociale që u themelua në bazë të Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974.

Aneksi B Intervistat me Pensionistët Kontribut Pagues

Për qëllimet e këtij studimi, pensionistë kontribut pagues konsiderohen të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët kanë punuar dhe kanë paguar kontributet e detyrueshme në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të ish KSAK sipas kornizës ligjore të ish RSFJ dhe ish KSAK.

Gjatë intervistave me përfaqësues të Federatës së Pavarur të Sindikatave të Pensionistëve, Invalidëve dhe të Moshuarve të Kosovës, dhe me disa pensionistë kontribut pagues, ata shpjeguan në mënyrë të qartë se tri argumente kyçe iu kanë shërbyer si bazë për aktivitetet e ndryshme në luftën për të mbrojtur të drejtën e tyre nga sigurimi pensional. Së pari, sipas kornizës ligjore të ish RSFJ dhe Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore, si dhe sipas ligjeve në fuqi në Serbi (bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë), Serbia ka shkelur të drejtën e tyre nga sigurimi pensional dhe invalidor, si e drejtë pronësore, duke ndërprerë në mënyrë arbitrare pagesën e sigurimit pensional dhe invalidor për pensionistët kontribut pagues kosovarë. Së dyti, Serbia i ka diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike pensionistët kontribut pagues shqiptarë dhe jo-serbë të Kosovës, meqë ka vazhduar t'ua paguaj sigurimin pensional dhe invalidor vetëm

⁵⁵Në vitin 1972, KSAK miratoi edhe Ligjin nr.37/72 mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor.

pensionistëve kontribut pagues serbë. Së treti, Serbia duke shkelur të drejtën e tyre për pension i ka penguar ata në shfrytëzimin e qetë të pasurisë, sipas Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore. Aktivitetet kyçe që pensionistët kontribut pagues kanë ndërmarrë së bashku apo edhe individualisht përfshijnë ngritjen e padive kundër UNMIK-ut, ngritjen e padive kundër Serbisë, takime dhe komunikime të vazhdueshme me institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe ngritjen e padive kundër qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sipas përfaqësuesit të Federatës së Pavarur të Sindikatave të Pensionistëve, Invalidëve dhe të Moshuarve të Kosovës, në bazë të kornizës ligjore të ish RSFJ dhe ish KSAK, e drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor ishte një e drejtë e fituar në bazë të pagesës së kontributeve të detyrueshme nga të ardhurat personale. Si e tillë, kjo e drejtë ligjërisht konsiderohej si një e drejtë personale, prandaj është e patjetërsueshme (shih Pjesën 4 të këtij dokumenti mbi detajet rreth kornizës ligjore që definonte të drejtën nga sigurimi pensional dhe invalidor si të drejtë pronësore). Duke iu referuar aktgjykimit të GJEDNJ në lëndën gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, përfaqësuesi theksoi se e drejta në pension konsiderohet nga kjo Gjykatë si e drejtë pronësore sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ. Po ashtu, KEDNJ duke iu referuar Nenit 110 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë ka theksuar se ‘të drejtat në sigurimin pensional dhe invalidor mund të shuhen vetëm nëse ndodhë që personi nuk i plotëson më kushtet origjinale ligjore.’ Të njëjtin përfundim/vendim e ka dhënë edhe Gjykata Kushtetuese e Serbisë lidhur me shuarjen e të drejtës së fituar në pension. Kjo nënkupton që askujt kjo e drejtë nuk mund t’i mohohet në mënyrë arbitrare. Rrjedhimisht, Serbia meqenëse në mënyrë arbitrare i ka ndërprerë pagesat e pensioneve për pensionistët kontribut pagues në Kosovë pa ndonjë paralajmërim apo arsyetim paraprak, e ka shkelur këtë të drejtë. Gjithashtu, duke vepruar në këtë mënyrë, Serbia i ka penguar pensionistët kontribut pagues të Kosovës në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tyre. Përfaqësuesi ngriti edhe çështjen se Serbia ka tentuar të arsyetojë ndërprerjen e pagesave të pensioneve në bazë të faktit se sistemi pensional bazohet në parimin e solidaritetit mes gjeneratave dhe se Serbia nuk ka arritur të mbledhë kontributet e detyrueshme pensionale në Kosovë prej vitit 1999. Më tutje, u shpjegua se ky arsyetim nuk ka bazë, prandaj është jorelevant, sepse, sipas aktgjykimit të

GJEDNJ-së që bazohet në Nenin 169 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë, një e drejtë në pension e njohur nuk varet nga fakti nëse qeveria ka pas mundësi apo jo të mbledhë kontributet pensionale në një territor specifik.

Përfaqësuesit, duke iu referuar vazhdimisht lëndës gjyqësore Grudic v. Serbia dhe lëndës gjyqësore Skenderi dhe katër aplikantë tjerë, argumentuan se meqë e drejta në pension është e drejtë pronësore dhe e patjetërsueshme, institucionet qeveritare kanë obligim ligjor ta respektojnë të njëjtën. Duke pasur parasysh këtë, u theksua se Federata vazhdimisht ka insistuar që institucionet e Kosovës të ofrojnë ndihmë për pensionistët kontribut pagues në kërkesën për vazhdimin e pagesës së pensioneve nga autoritetet e Serbisë përmes Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Beograd, në të cilin pensionistët kanë paguar kontributet e detyrueshme për 40 vite. Federata gjatë takimeve dhe komunikimit me institucione dhe akterët tjerë ka shpjeguar dhe ka insistuar vazhdimisht se vazhdimi i pagesës është zgjidhja e vetme e pranueshme, e drejtë, ligjore dhe jo arbitrare, sepse e drejta në pension është e drejtë pronësore që është e patjetërsueshme. Rrjedhimisht, e drejta në pension nuk mund të jetë subjekt i ndonjë zgjidhjeje politike. Çfarëdo zgjidhje politike për këtë problem që nënkupton zvogëlimin apo mosvazhdimin e pagesës së pensioneve do të përbënte shkelje të së drejtë në pension të pensionistëve kontribut pagues. Opinioni i Federatës se zvogëlimi apo mosvazhdimi i pagesës së pensioneve është antiligjor bazohet në aktgjykimin e GJEDNJ-së. Po ashtu, u cek se Federata vlerëson se, për shkak të situatës së dobët financiare të pensionistëve kontribut pagues, është e papranueshme që ata të detyrohen ta padisin shtetin e Serbisë individualisht dhe të paguajnë tarifa të larta për avokatët dhe përfaqësuesit ligjorë.

Sipas lëndës gjyqësore Grudic ndaj Serbisë, qeveria e Serbisë ka pretenduar se gjykatat e Serbisë nuk mund të gjykojnë mbi “meritat e pretendimit për pensionistët paditësit”, sepse dokumentacioni ose mungon ose është shkatërruar dhe për shkak të ngurrimit të institucioneve të Kosovës që të bashkëpunojnë në këtë çështje. Në lidhje me këtë çështje, një nga përfaqësuesit tha se Federata ka kaluar në një proces të gjatë dhe sfidues gjatë të cilit ka tentuar të ketë qasje në dokumentacionin e pensionistëve kontribut pagues deri në vitin 1998 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës (MPMS). Në vitin 2016, prapë zyrtarisht Federata ka kërkuar nga Ministria në fjalë t’i mundësojë

qasje në këtë databazë. Për shkak të neglizhencës dhe ngurrimit të MPMS, Federata ka paditur Ministrinë lidhur me këtë çështje, por pa sukses. Duhet të theksohet se në vitin 2013, Ministria në fjalë nuk i ishte përgjigjur as kërkesës së Komisionit Profesional Qeveritar të Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën për kompensim të pensionistëve kontribut pagues kosovar nga qeveria e Serbisë për shkak të ndërprerjes së paligjshme të pagesës së pensioneve. Rrjedhimisht, në vitin 2018, Federata paditi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë në bazë të ankesës se Ministria kishte heshtur dhe nuk i ishte përgjigjur kërkesave dhe ankesave të Federatës lidhur me qasjen në dokumentacionin mbi pensionistët kontribut pagues të viteve të 1990ta. Arsyetimi i MPMS për heshtjen dhe mospërgjigjen ndaj kërkesave dhe ankesave të ishte se e njëjta do të shkelte Ligjin nr. 03/L-172 mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëse e njëjta do t'i ofronte qasje në këtë dokumentacion Federatës. Sipas aktgjykimit të Gjykatës ankesa e Federatës ishte e bazuar dhe MPMS u urdhërua që t'i ofrojë Federatës qasje në regjistrin e pensionistëve kontribut pagues të viteve të 1990ta. Pas aktgjykimit, Federata pranoi një kopje të këtij regjistri.

Përfaqësuesit treguan se, pas luftës, e drejta në pension e pensionistëve kontribut pagues ishte shkelur nga UNMIK dhe nga institucionet e Kosovës. Sipas tyre, Rregullorja e UNMIK 2001/35 mbi themelimin e fondit pensional dhe invalidor dhe të gjitha dokumentet ligjore përcjellëse të miratuara nga Kuvendi e Republikës së Kosovës gjatë administrimit të UNMIK dhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, kanë paraparë një trajtim diskriminues të pensionistëve kontribut pagues. Kjo sepse Rregullorja 2001/35 që përcakton pensionin bazë nuk e ka njohur të drejtën në pension të fituar nga pensionistët kontribut pagues nga fondi i vjetër. Përkundrazi, rregullorja i ka diskriminuar ata, sepse e njëjta bazohet në parimin e mbulimit univerzal duke ofruar pension bazë për të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë mbushur moshën 65 vjeçare, pavarësisht nga përvoja e punës, stazhi pensional dhe shuma e kontributeve të detyrueshme të paguara. Në vitin 2007, qeveria e Republikës së Kosovës në një tentim ligjor për të njohur të drejtën në pension të pensionistëve kontribut pagues mori vendimin për rritjen e pensionit bazë për 35 Euro në muaj për pensionistët të cilët mund të dëshmonin se kanë paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional. Ky vendim ishte prapë diskriminues, sepse i

diskriminonte ata të cilët kanë paguar kontribute të detyrueshme për më pak se 15 vite, meqë i trajtonte njëjtë me pensionistët që nuk kanë pas asnjë ditë përvojë pune para vitit 1999. Përfaqësuesit e Federatës shpjeguan se të gjithë pensionistët kontribut pagues pajtohen në këtë që u tha lidhur me faktin se korniza ligjore e Republikës së Kosovës i trajton ata në mënyrë diskriminuese dhe se ua shkelë të drejtën në pension. Po ashtu, ata treguan se pas konsultimeve me ekspertët ligjorë, avokatët dhe ekspertët e fushës së pensioneve, ajo çka ata marrin si pension ligjërish duhet të definohet si asistencë sociale. Kjo pasi që pensionet që marrin paguhen direkt nga buxheti i shtetit dhe jo nga fondi pensional në të cilin i kanë paguar kontributet e detyrueshme. Prandaj, ajo çka ata marrin nuk është pension por asistencë sociale dhe duhet të definohet si e tillë në legjislacionin ekzistues.

Përfaqësuesit e Federatës thanë se pensionet e tyre që marrin që nga themelimi i fondit pensional janë të pamjaftueshme. Pensionet kanë mbetur të pamjaftueshme edhe pas vendimit qeveritar të vitit 2007 kur pensionet e pensionistëve kontribut pagues u rritën për 35 Euro në muaj. Në lidhje me këtë, ata i referohen edhe opinionit të PKDNJ sipas të cilit thuhet se pensioni “nuk ishte adekuate për t’i siguruar qasje ankuesit në shërbimet themelore dhe të mirat e nevojshme për realizimin e një standardi adekuat të jetesës dhe shëndetit”⁵⁶. Ata pretendojnë se situata financiare e pensionistëve kontribut pagues është edhe më e dobët se sa që shpjegohet në raportin e GLPS. Sipas tyre, krahasuar me shumën në të cilën kanë të drejtë ligjërish, duke iu referuar këtu pensioneve që i marrin pensionistët kontribut pagues serbë të Kosovës nga fondi i Beogradit, pensioni i tyre është larg nga të qenurit pension i drejtë dhe i mjaftueshëm për të siguruar një standard adekuat të jetesës, sidomos kur merret parasysh fakti që ata kanë paguar kontribute të detyrueshme gjatë kohës që kanë punuar.

⁵⁶ Paneli Këshilldhënës mbi të Drejtat e Njeriut (2016), ‘Krasniqi v. UNMIK’, fq.16. Në dispozicion në: http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Cases%20Eng/08_10%20Krasniqi%20FINAL%2017may16.pdf [Qasur më: 10 shtator 2019].

